



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:  
“Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”  
Universiteti i Tiranës**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Asoc. Dr. Gafur MUKA**

**Dr. Nevila ÇINAJ**

**Nëntor / 2022**

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Master profesional në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjeografisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	MP në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër nr.616, datë 28.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.347, datë 25.11.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i II- të
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	<b>4 PAE /4 PAK</b> (ngarkesa mësimore <b>50% PAE /50% PAK</b> )
18	Numri i studentëve:	- 2019 - 2020: 25 studente; - 2020 - 2021: 25 studente; - 2021 - 2022: 21 studente;
19	Komente / të tjera:	

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 207, datë 30.05.1957. Universiteti i Tiranës zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 26.10.2022. Universiteti i Tiranës është i organizuar në 8 Njësi Kryesore, konkretisht:

1. Fakulteti i Drejtësisë;
2. Fakulteti i Ekonomisë;
3. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;
4. **Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë;**
5. Fakulteti i Shkencave Sociale;
6. Fakulteti i Shkencave Natyrore;
7. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar;
8. Instituti i Studimeve Europiane;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Master Profesional në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”, licensuar sipas Urdhërit Nr. 616 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, datë 28.09.2018, që realizohet me 120 kredite në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy), vite akademike, 4 semestra.

Programi i studimit Master Profesional në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar” ofrohet nga **Departamenti i Gjeografisë**, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (FHF).

FHF është i organizuar në gjashtë departamente:

1. Departamenti i Gjeografisë;
2. Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore;
3. Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit;
4. Departamenti i Gjuhësisë;
5. Departamenti i Historisë;
6. Departamenti i Letërsisë;

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar, të ofruar nga Departamenti i Gjeografisë pranë Universitetit të Tiranës, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Gafur Muka dhe Dr. Nevila Çinaj.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorët Teknik të ASCAL-it, Znj. Juna Mengri dhe Znj. Majlinda Demirneli.

Vizita 2 ditore në Universitetin e Tiranës u realizua gjatë datave 20-21 Korrik 2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit të Tiranës (Fakulteti Histori Filologji, Departamenti i Gjeografisë). Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.10.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/126 Prot, datë 12.10.2022. Universiteti i Tiranës më datë 25.10.2022, njofton nëpërmjet sistemit AMS, mbi dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “SIG i Aplikuar”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	IAL që ofron programin e studimit (PS) Master Profesional në “SIG i Aplikuar” është Universiteti i Tiranës. Ky institucion është hapur me VKM Nr. 207, datë 30.05.1957, dhe është akredituar në nivel institucional nga ASCAL me vendimin Nr. 84, datë 27.10 2018 për një periudhë 4 vjeçare, e cila përmbyllet më 26.10.2022. Mbështetur në dokumentacionin ligjor të kërkuar për hapjen e PS, ky institucion ka hartuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe, mbi këtë bazë është miratuar hapja e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar”, me urdhërin e Ministrit të Arsimit Nr. 616, datë 28.09.2018. Ky urdhër është lëshuar duke patur parasysh që ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. GVJ konsultoi dokumentacionin ekzistues dhe konstaton përmbushjen e këtij kriteri. <i>RVB, Evidencat 1, 2, 3, 4, 5, 40, 41, Shënimet nga vizita në institucion.</i>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është hapur me misionin: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të realizojë formimin profesional të gjeografëve të ardhshëm;</li><li>• Të kultivojë tek ata aftësitë për gjetjen, seleksionimin dhe klasifikimin e informacionit praktik dhe ta përdorin atë në profesionin e tyre;</li><li>• Të aftësojë specialistët e ardhshëm për realizimin e vrojtimeve, matjeve, sondazheve dhe anketave në terren, duke punuar individualisht ose në grup;</li><li>• Të krijojë shprehje dhe shkathtësi në orientimin drejt në burimet e informacionit statistikor, ndërtimin e pasqyrave, grafikëve, planeve dhe hartave tematike etj.përmes përdorimit të SIG-sit;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të kultivojë frymën e bashkëpunimit, pranimit të kritikës shkencore dhe respektimit të mendimit ndryshe;</li> </ul> <p>Mbështetur në dokumentacionin ekzistues, prodhuar sipas kërkesave ligjore si dhe arritjet 4 vjeçare për realizimin e këtij misioni, GVJ gjykon që ky PS synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. <i>RVB, Evidencat 1, 2, 3, 4, 5, 40, 41, Shënimet nga vizita në institucion.</i></p>								
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. GVJ, gjatë vizitës në institucion, konsultoi dokumentacionin e vënë në dispozicion, verifikoi referencat ligjore, bisedoi me personelin akademik dhe studentët, u informua për punëzënjen e të diplomuarve dhe, mbi këtë bazë, konkludon plotësimin e këtij kriteri. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat 2, 4, 5, 11, 12, 64.</i>								
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	GVJ duke u nisur nga dokumentacioni i prodhuar për hapjen e programit, interesi i studentëve për ta ndjekur, niveli i punëzënjes së tyre, institucionet që kanë interes për ti punësuar të diplomuarit e këtij PS, konstaton që PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është hartuar dhe ofrohet në plotësim të këtij kriteri. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat 11, 12, 63, 64, 70, 72.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ, duke u mbështetur në materialet e vëna në dispozicion si dhe gjatë vizitës në institucion, konstaton që PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e UT për zhvillimin e tij. Në statutin e UT thuhet: “Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të

	<p>misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën. Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxisim rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale”. Sa më sipër konkludohet që kriteri plotësohet. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 2, 5.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin e UT përcaktohen drejtimit prioritar akademike të tij formuluar në zbatim të përcaktimeve ligjore. Konkretisht në nenin 5 të tij, tek misioni, përcaktohet që: “Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën”. PS Master professional “SIG i Aplikuar” është hartuar dhe ofrohet mbështetur në këtë mision. GVJ konsultoi dokumentacionin e prodhuar për hapjen e këtij PS si dhe përvojën 4 vjeçare të funksionimit të tij dhe konstaton plotësimin e këtij kriteri. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat 2, 4, 5, 12, 13.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>PS Master profesional “SIG i Aplikuar” zhvillohet në Departamentin e Gjeografisë, të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë si njësi e Universitetit të Tiranës. Kurrikula e tij është hartuar në kuadrin e projektit GEOWEB, me pjesëmarrjen e një stafi të trajnuar enkas për hapjen e këtij PS, si dhe në bashkëpunim me ekspertët e kësaj fushe. GVJ konsultoi gjithë dokumentacionin që lidhet me përmbajtjen e programit dhe konkludon që kjo përmbajtje përputhet plotësisht dhe integrohet natyrshëm në fushat e drejtimit akademike të UT. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat 2, 4, 5, 13, 27, 64.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi që hapja e këtij programi është sugjeruar dhe është asistuar në kuadrin e realizimit të projektit GEOWEB. Departamenti i Gjeografisë kishte aplikuar dhe kishte fituar këtë projekt duke realizuar objektivat e tij për bashkëpunim në kuadrin e programeve ERASMUS +. Përmbajtja e këtij programi lidhet me modernizimin e arsimit në fushën e krijimit dhe përdorimit të të dhënave hapsinore. Vendi ynë e ka në strategjinë e</p>

	bashkëpunimit me jashtë modernizimin e arsimit në përgjithësi dhe është pjesëmarrës në shumë projekte të programit ERASMUS+. Në këtë kuadër konkludohet që PS Master profesional “SIG i Aplikuar” zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 3, 12, 41, 29.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Në propozimin për hapjen e këtij PS, janë marrë parasysh, krahas aspekteve thjesht financiare të hapjes së një programi të ri studimi, edhe kushtet e projektit GEOWEB, në kuadër të të cilit është propozuar çelja e këtij programi. Këto kushte, të specifikuar më poshtë janë të bazuara në principet dhe parimet e programit Erasmus+ të Komisionit Evropian, i cili është financuesi i projektit GEOWEB, ku Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Tiranës, është partner-thuhet tek kërkesa për master profesional. Po në këtë kërkesë përcaktohen objektivat e programit, jepen profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit, njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin (të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme), mundësitë për punësim etj. GVJ mbështetur në dokumentacionin përkatës si dhe duke shqyrtuar përvojën e zbatimit të PS konkludon që kriteri përmbushet plotësisht. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 12, 13, 41, 29.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë:	Në evidencën “Studim tregu” tek paragrafi “Qëllimi” thuhet: <i>“Qëllimi i realizimit të këtij studimi tregu është njohja e tregut të punës dhe kërkesave për specialist SIG në institucione, agjenci, ministri, bashki etj në vendin tonë”.</i> GVJ e konsultoi këtë dokument dhe konstaton që metodologjia e përdorur (anketim institucionesh) ka prodhuar një listë institucionesh që kërkojnë të diplomuarit e PS Master Profesional “SIG i



<p>të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Aplikuar”. Gjatë vizitës në institucion u konstatua që pothuajse të gjithë të diplomuarit e viteve 2019-2020, 2020-2021 janë punësuar në këto institucione. Po ashtu, nga Departamenti i Gjeografisë, në kuadrin e projekteve GEOWEB dhe GEOBiz është konstatuar nevoja për këta specialistë edhe në tregun ndërkombëtar. Mbështetur në këtë konstatim departamenti ka propozuar që përveç gjuhës shqipe, ky program të lektohet edhe në anglisht. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 12, 63.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konsultoi kurrikulën e programit, përmbajtjen e syllabuseve, rezultatet e anketimeve të studentëve si dhe pati takime me personelin akademik dhe studentët. Nëpërmjet këtij aktiviteti, GVJ u informua jo vetëm mbi objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen e PS por edhe rezultatet e arritura në përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave dhe konstaton që ato i përgjigjen plotësisht nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 13, 16, 26, 27, 34, 63.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ mësoi që PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është hapur në kuadrin e zbatimit të projektit GEOWEB, një nga objektivat më të rëndësishme të të cilit, në kuadrin e programit ERASMUS, ishte modernizimi i arsimit. Në këtë kuadër, si kurrikula e tij ashtu edhe syllabuset e lëndëve janë dizenuar në nivelin e standardeve evropiane çfarë lehtëson transferimin e studimeve si dhe punësimin në tregun ndërkombëtar. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 12, 13, 16, 41.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Në kërkesën për hapjen e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” thuhet: në propozimin për mbështetjen e këtij PS janë marrë parasysh edhe kushtet e projektit GEOWEB, në kuadër të të cilit është propozuar çelja e tij. Këto kushte, të specifikuar më poshtë, janë të bazuara në principet dhe parimet e programit Erasmus+ të Komisionit Evropian, i cili është financuesi i projektit GEOWEB, ku Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Tiranës, është partner.</p> <p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, konkludon përmbushjen e këtij kriteri. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 5, 12, 41.</i></p>

**Kriteri 6.** Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.

Në plotësim të këtij kriteri, GVJ konsultoi objektivat e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar”. Këto objektiva janë:

1. Aftësimi i studentëve në përdorimin e SIG-ut të aplikuar në gjetjen e informacionit dhe konceptimin e projekteve planifikuese dhe zhvillimore me rëndësi për zhvillimin ekonomik, social, territorial dhe mjedisor;
2. Edukimi i studentëve për punë kërkimore efikase dhe përmes përdorimit të teknikave, dhe teknologjive të bashkëkohore të SIG-ut;
3. Formimi profesional i specialistëve për vlerësimin dhe promovimin e metodave dhe teknikave të avancuara në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit;
4. Formimi i specialistëve të aftë për punë në grup dhe studime ndërdisiplonore;
5. Zhvillimi i mundësive për krijimin e ekspertëve apo të grupeve të ekspertëve që do të mund të atashohen pranë subjekteve publike dhe private, ku do të mund të kontribuojnë me studime cilësore hapësinore, ekonomike, sociale etj;
6. Kontributi për vënien e SIG-ut plotësisht në shërbim të studimeve dhe të zhvillimit të vendit;

Për përmbushjen e këtyre objektiveve në kurrikulën e PS janë parashikuar ushtrime, seminare, laboratore si dhe praktika profesionale. Janë vënë në dispozicion të studentëve 2 laboratorë të paisur me teknologjinë e viteve të fundit, financuar nga projekti GEOWEB, janë nënshkruar kontrata për kryerjen e praktikave në institucionet bashkëpunuese etj. Po ashtu në kuadrin e programit ERASMUS+ janë parashikuar e janë kryer edhe shkëmbime studentësh dhe kualifikime të PA.

*RVB, Shënime nga vizita në institucion, Evidencat: 5, 12, 16, 22, 41.*

**Kriteri 7.** Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.

Në takimin me dekanin e FHF dhe Përgjegjës të Departamentit të Gjeografisë, po ashtu edhe nga takimi në Zyrën e Kurrikulave, GVJ mësoi që ky program do lektohet krahas gjuhës shqipe edhe në gjuhën angleze me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.

*RVB, Shënime nga vizita në institucion.*

<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Në takimin me NJSBC dhe GVB, GVJ mësoi që po shqyrtohet mundësia, që në kuadrin e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” të ofrohen programe për paisjen me njohuritë bazë të të gjithë aplikuesve, që nuk vijnë nga studimet bachelor të departamentit të gjeografisë.</p> <p>GVJ e mbështet këtë objektiv dhe rekomandon realizimin e tij.</p> <p><i>Shënimet nga vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

#### Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, si institucioni që ofron PS Master Profesional “SIG i Aplikuar”, është institucion publik i arsimit të lartë, në përbërje të të cilit janë 8 Fakultete (Njësi kryesore) dhe rreth 41 Departamente (Njësi bazë). Ai funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Gjeografisë, i cili disponon përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për realizimin e tij. GVJ konstatoi që për zhvillimin e aktiviteteve mësimore e shkencore në funksion të PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është angazhuar një personel i përbërë nga <b>4 PAE dhe 4 PAK</b>, të cilët janë trajnuar edhe në kuadër të projektit GEOWEB. Po kështu në funksion të këtij PS janë edhe dy laboratorë me kapacitete përkatësisht 28 dhe 15 vende të kompletuar me paisje, programe e teknologji bashkëkohore të dy viteve të fundit, me financime nga projekti GEOWEB. Programi shfrytëzon infrastrukturën e përbashkët të departamentit dhe FHF si bibliotekën, auditoret, ambientet e çlodhjes, banjot etj. Aktualisht PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” përfiton fonde për modernizimin e mëtejshëm të procesit mësimor dhe aktivitetit shkencon në kuadër të projektit GEOBiz.</p> <p>Referuar dokumentit të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton se Fakulteti i Histori Filologjisë për vitin akademik</p>

	<p>2021 -2022 ka gjithsej <b>212 pedagogë</b>, nga të cilët <b>93 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 21 Prof. Dr;</li> <li>- 27 Prof. Asoc;</li> <li>- 2 Akademik;</li> <li>- 36 Dr;</li> <li>- 7 Msc;</li> </ul> <p>dhe <b>119 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 20 Prof. Dr;</li> <li>- 13 Prof. Asoc;</li> <li>- 1 Akademik;</li> <li>- 37 Dr;</li> <li>- 48 Msc;</li> </ul> <p>Ndërsa Departamenti i Gjeografisë, përgjegjës për këtë program studimi ka <b>20 PAE</b> dhe <b>13 PAK</b>.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia kryesore / bazë kanë kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar programin e studimit.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 2, 3, 4, 5, 12, 24, 25, 57,68</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” lidhet me njohuritë që merren në diplomën Bachelor të Departamentit të Gjeografisë, i cili është njësi bazë e Universitetit të Tiranës, inkuadruar në FHF si njësi kryesore. Aplikantët për këtë PS vijnë kryesisht nga kjo diplomë. Ata mund të vijnë edhe nga diploma të ngjashme si ato të Bch në gjeodezi e gjeoinformatikë. Kurrikula dhe syllabuset e këtij programi janë hartuar në kuadrin e Programit ERASMUS+, mbështetur në projektin GEOWEB. Po kështu me mbështetjen e këtij projekti është realizuar dhe infrastruktura mësimore e ajo shkencore. GVJ gjykon që ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 5, 11,12, 13, 16, 41</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë,</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Gjeografisë që është njësi bazë përgjegjëse e këtij PS.</p>

<p>përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në shqyrtimin e gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ konstaton që nuk është rasti i një programi ndërdisiplinor. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 5, 11, 12, 41</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Referuar faktit që programi i studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” i ofruar nga Departamenti i Gjeografisë lidhet me krijimin, përpunimin dhe vlersimin e informacionit gjeografik, konkludohet që ky PS është në linjën e profilit të institucionit konkretisht në fushën e shkencave shoqërore dhe cilësia e tij garantohet kryesisht nga UT me mbështetje edhe të institucioneve partnere</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka përcaktuar në organogramën e vet njësitë përbërse të tij ku bëjnë pjesë 8 njësi kryesore (fakultete) dhe rreth 41 njësi bazë (departamente). Marrdhëniet midis tyre janë përcaktuar me ligje e dispozita ligjore në dokumentat themelore (statut, rregullore) si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel njësisish dhe zyrash. Në shqyrtim të këtyre dokumenteve si dhe takimeve të organizuara, GVJ vleron se marrdhëniet brenda institucionit janë bashkëpunuese me detyra të përcaktuara dhe me të drejta e përgjegjësi të njohura e të realizuara. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 2, 3, 4, 5</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Dokumentacioni i ofruar dëshmon që për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, UT, FHF dhe Departamenti i Gjeografisë kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendës dhe të huaj. Në kuadrin e 2 projekteve të fituara tek programi ERASMUS+ (GEOWEB, GEOBiz) janë shkëmbyer përvoja e kanë realizuar trajnime në universitetet homologe në Spanjë, Austri, Novi Sad etj. Po ashtu ka edhe mobilitet të studentëve. GVJ konsultoi dokumentacionin e ofruar si dhe, gjatë vizitës në institucion, u informua për këto marrëdhënie dhe vlerëson përmbushjen e këtij kriteri. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 21, 22, 69, 72.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>UT (FHF), lidhur me PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” ofrojnë dëshmi për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucionet arsimore ndërkombëtare (bashkëpunimi në kuadrin e projekteve GEOWEB dhe GEOBiz). Gjithashtu lidhja e memorandumëve të bashkëpunimeve me institucione vendase si Bashkitë e Tiranës, Librazhdit, Prrenjasit, INSTAT, ISHP etj mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentët në mjediset ku ata kanë shansin të punësohen me përfundimin e studimeve. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 21, 22, 69, 72, 73.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë konsultimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe gjatë takimeve në institucion, GVJ vlerëson që janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit e ardhshëm të të diplomuarve në këtë PS. Si të tillë konsiderohen bashkitë, INSTAT, ASHK, AKT, ISHP etj. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 21, 22, 69, 72, 73.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.</p>	<p>UT dëshmon që ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit. Në institucion funksionon tashmë Zyra e Karrierës e cila i trajnon studentët si të aplikojnë për punë, si të shkruajnë një CV apo letër motivimi. Gjatë takimit në zyrën e karrierës mësuam se nga kjo zyrë organizohet dhe “Java e Karrierës” një aktivitet, siç u pohua dhe nga studentët, mjaft i dobishëm për ta. Në kuadrin e trajnimeve profesionale organizohet dhe “Dita e SIG, GIS Day” mbështetur nga ESRI. Kontakte të vazhdueshme mbahen edhe me punëdhënësit të cilët ftohen dhe frekuentojnë</p>

	aktivitetet e Departamenti të Gjeografisë si dhe kanë raporte të mira pune dhe personale me personelin akademik. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidencat: 21, 22, 47.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Në RVB thuhet: Departamenti i Gjeografisë zhvillon në mënyrë periodike tryeza të rumbullakta në drejtim të analizave për hartimin e raporteve lidhur me përfitimet profesionale dhe akademike që studentët marrin nga organizimi i trajnimeve. Në takimin me studentët e PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” GVJ u informua mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Duke patur parasysh kohën e shkurtër nga hapja e këtij programi si dhe intensitetin e bashkëpunimit me institucionet partnere në kuadrin e programit GEOWEB, GVJ gjykon që Institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” është i organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite ECTS. Ai është zhvillohet në dy vite akademike. Numri i krediteve për vit akademik është 60 ECTS. Numri i lëndëve/moduleve është 13, të klasifikuara si: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe lëndë plotësuese. Kjo shpërndarje plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të krediteve brenda kornizës ligjore, e cila parashikon studime me kohë të plotë dhe maksimumi 120 kredite ECTS. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13.</i>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Kurrikula e PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” është hartuar në kuadrin e realizimit të projektit GEOWEB, objektivat e të cilit ishin ndër të tjera edhe modernizimi i procesit mësimor. Në këtë kuadër lëndët/modulet janë strukturuar në mënyrë të tillë që të realizojnë formimin e shprehive të veçanta në fushën e krijimit, administrimit, vlerësimit dhe vizualizimit të të dhënave hapsinore. Nga takimi me studentët, GVJ mësoi që njohuritë e marra në këtë PS i integrojnë ata shpejt dhe me kompetencë në tregun e punës (zyrat e bashkive, INSTAT, Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Teritorit (AKPT), Agjensia Kombëtare e Turizmit (AKT) etj <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13, 35</i>
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” nëpërmjet lëndëve karakterizuese dhe interdisiplinore/integruese i profilizon studentët për të zhvilluar modele tematizimi në funksion të fushave të aktivitetit, duke parë me sy kritik funksionimin dhe dobinë e tyre. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13, 35</i>
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale,	Të diplomuarit e PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e modeleve tematike, në mënyrë që të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme. Në takimin me studentët, një studente e punësuar tashmë, tha që

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 16



të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	ajo ishte në gjendje të shkruante scripture për të gjetur rrugëzgjidhje sa më të leverdisshme në procesin e modelimeve. (Shënojmë që kjo studente kishte mbaruar më parë studimet master në informatikë).			
	<i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 35.</i>			
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Kurrikula e PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” është hartuar në kuadrin e realizimit të projektit GOEËEB dhe është konsultuar me ekspertë vendas. Në këtë kuadër ajo merr në konsideratë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.			
	<i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13, 16, 35, 64</i>			
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	GVJ konsultoi RVB si dhe evidencat që dëshmojnë kurrikulën e PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” dhe konstaton që ajo i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese (bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese dhe plotësuese). Ato janë të paisura me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS duke përbushur të gjitha detyrimet e përcaktimet ligjore.			
	<i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13.</i>			
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Në PS Master Profesional në “SIG i Aplikuar” ngarkesa për praktikën profesionale është parashikuar në vitin e dytë, në masën e 12 ECTS që përbën 10% të ngarkesës së përgjithshme, duke respektuar përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.			
	<i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Referuar dokumentacionit të dorëzuar për akreditim si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Departamenti i

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 17

<p>përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Gjeografisë, si njësi bazë për PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” përbush detyrimet ligjore për akreditim. PS është hapur me urdhërin e Ministrit nr.616 datë 28.09.2018 në të cilin thuhet: Universiteti i Tiranës i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë PS Brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Bazuar në këto akte ASCAL, me kërkesën e UT, ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe ka ngritur grupin e ekspertëve të jashtëm për akreditim. GVJ vlerëson që përbushen të gjitha detyrimet ligjore për këtë proces.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 1, 2, 4, 5, 52</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Për përbushjen e këtij kriteri, GVJ konsultoi gjithë aktet ligjore e nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është hapur me kërkesën e Departamentit të Gjeografisë, i cili ka përgaditur gjithë dokumentacionin e nevojshëm, depozituar në dosjen përkatëse. Ky departament është përgjegjës për PS. Departamenti nga ana e tij funksionon në përbërje të njësisë kryesore që është FHF, ndërsa kjo fundit funksionon si njësi kryesore e UT. E gjithë vendimmarrja për ecurinë e këtij programi mësimor kalon nëpërmjet Departamentit të Gjeografisë, FHF dhe UT, rregulluar nëpërmjet Statutit dhe rregulloreve përkatëse.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 1, 2, 3, 4, 5.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Njësia kryesore për këtë program studimi është FHF. Kjo njësi përbëhet nga 6 departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Historisë;</li> <li>2. Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore;</li> <li>3. Departamenti i Gjeografisë;</li> <li>4. Departamenti i Gjuhësisë;</li> <li>5. Departamenti i Letërsisë;</li> <li>6. Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit;</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia bazë për PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është Departamenti i Gjeografisë.</p> <p>Personali akademik për FHF është:</p> <p>PAE 93 PAK 119 P ndihmës akademik 6</p>

Gjithsej 218

Personeli akademik për Departamentin e Gjeografisë është:

PAE 20

PAK 13

P ndihmës akademik 1

Gjithsej 34

Personeli akademik i angazhuar në PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” (viti 2021-2022) është:

PAE 4

PAK 4

P ndihmës akademik 1

Personeli akademik i Departamentit të Gjeografisë sipas titujve dhe gradave shkencore listohet në tabelën e mëposhtme:

Departamenti i Gjeografisë	Viti akademik 2021-2022	
	PAE	PAK
Prof Dr	7	2
Prof.Assoc	4	4
Dr	6	5
Msc (Dr në proces)	1	-
Msc	2	2
Ne total	<b>20</b>	<b>13</b>

Departamenti i Gjeografisë i përmbush detyrimet ligjore duke realizuar aktivitetet brenda vetes dhe duke shpërndarë peshën e punës te seicili individ. Edhe raporti i vlerësimit të brendshëm për programin PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është i hartuar nga stafi i Departamentit, me kryetare të grupit – Dr. Enkela Begu. Departamenti i Gjeografisë përmbush detyrimet ligjore duke organizuar dhe zhvilluar mësimin, vlerësimet e studentëve, vlerësimet e pedagogëve në mënyrë të vazhdueshme. Ai shqyrton programet e studimit brenda vetes, analizon kërkesa të ndryshme të stafit akademik, studion nevojat e departamentit. Departamenti i përgjigjet Dekanit të Fakultetit.

	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është mbartësi kryesor që çon më tej përmbushjen e objektivave kryesore dhe të veçanta. Ne çdo fillim viti akademik diskutohen syllabuset e çdo lënde në grupe të ngushta në mënyrë që vazhdimisht të përmirësohen dhe përsosen rezultatet e nxënies. Struktura akademike është e rregulluar në nivel të Universitetit përmes kontratave dhe përcaktimit të detyrave kontraktuale ndërsa për zhvillimin e veprimeve akademike kujdeset njësia bazë – Departamenti përkatësisht Fakulteti.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 1, 2, 3, 4, 5, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Departamenti, i cili merret me organizimin dhe menaxhimin e programit Master Profesional “SIG i Aplikuar” është plotësisht i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë dhe detyrimet që kanë për realizimin e programit, duke respektuar kriteret ligjore për nivelin e studimeve Master Profesional. Gjatë vizitës së GVJ, në takimet me studentët, konstatoam se praktika mësimore udhëhiqet nga personeli akademik i departamentit. Gjithashtu edhe ushtrimet laboratorike në ambientet e Universitetit udhëhiqen nga stafi akademik ndihmës. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Gjeografisë si njësia bazë përgjegjëse për PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i këtij PS është Prof. Asoc. Dr. S. Xh.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 20</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi dokumentacionin që lidhet me ecurinë e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar”, dhe konstatoi që koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i departamentit dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 20</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.3

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” është Departamenti i Gjeografisë. Në gjithë aktivitetin e tij, në realizimin e përgjegjësive për ecurinë e PS, kjo njësi mbështetet në aktet ligjore e nënligjore, të prodhuara për këtë qëllim. Konkretizimi i këtij aktiviteti dëshkohet nga dokumentacioni që iu vu në dispozicion GVJ. Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënje në këtë program studimi. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 2, 3, 4, 5, 13, 16, 68.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë, konsiderohet si vazhdim i studimeve të ciklit të parë Bsc në Gjeografi, i cili jep formim më të gjerë në fushën e gjeografisë. Programi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është zhvilluar në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me urdhërin nr 616, datë 28.09.2018. Planin mësimor i PS përmban praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës, nëpërmjet të cilave studenti fiton dhe realizon shprehjet profesionale si dhe dëshmon aftësitë për të realizuar punime të pavarura.</p> <p>Ky program zhvillohet në dy vite akademike me 60 ECTS për çdo vit akademik. Ai plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të krediteve brenda kornizës ligjore 7, e cila për programe të tilla parashikon studime me kohë të plotë me 120 kredite ECTS.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13, 16, 68.</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Program i studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” është hartuar në realizim të projektit GEOWEB, me konsulencë të ekspertëve për strukturimin e kurrikulës dhe përmbajtjen e syllabuseve. Në formën përfundimtare ai përmban të gjitha informacionet që lidhen me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, frekuentimin e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. GVJ konstaton që ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 13, 16, 68.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitave në institucion dhe në takimin me studentët, GVJ u informua për raste të transferimeve të studentëve nga institucionet e tjera në PS Master Profesional “SIG i Aplikuar (1 studente kishte ardhur pasi kishte përfunduar studimet e të dy cikleve në informatikë dhe 1 tjetër pasi kishte mbaruar studimet e ciklit të parë në inxhinjeri mjedisi).</p> <p>Programi i studimit është lehtësisht i mundur të krahasohet me programe nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare për fushën e informacionit gjeografik. Këtë e mundësojnë lëndët brenda kurrikulës, pesha e tyre si dhe përmbajtja, të kolauduara këto edhe në konsultimet me specialistë të huaj në kuadrin e projektit GEOWEB, edhe me specialistë vendas.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>PS Master Profesional “SIG i Aplikuar i ka të gjitha informacionet e nevojshme për secilën lëndë (syllabuset) ku jepen, sipas kërkesave ligjore: titullari i lëndës, ngarkesa e përgjithshme dhe e detajuar për orët në auditor (leksione seminare/ushtrime, labore/teorjike/praktika), tipologjia e lëndës, viti akademik dhe semestri kur zhvillohet. Po ashtu, çdo syllabus përmban edhe temat e mësimave, formën e kontrollit të dijeve, detyrimin për frekuentimin si dhe literaturën (të klasifikuar si literaturë bazë dhe e rekomanduar). GVJ i konsultoi të gjitha syllabuset e lëndëve të kurrikulës dhe konkludon që ato janë konform formateve të miratuara.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me personelin akademik, u interesua të informohej lidhur me nevojat për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve. Titullarët e lëndëve konfirmuan që në përvojën e këtyre 4 viteve ndryshimet janë të vogla, por ata janë në kontakt me zhvillimet më të reja në këtë fushë, edhe në kuadrin e projektit GEOBiz,</p>

ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	dhe do ti reflektojnë ndryshimet edhe nëpërmjet propozimeve për ndryshime në kurrikulë edhe në përmbajtjen e syllabuseve. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																									
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Ngarkesa e PS MP “SIG i Aplikuar” është e shpërndarë në semestra (gjithsej 4) dhe në vite akademike (gjithsej 2). Në kredite ngarkesa simestrale është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Semestri i parë 24 ECTS;</li> <li>- Semestri II 36 ECTS;</li> <li>- Semestri III 24 ECTS;</li> <li>- Semestri i IV 36 ECTS;</li> <li>- ndërsa ngarkesa vjetore është 60 ECTS për seicilin vit;</li> </ul> <p>Mungesa e shpërndarjes së njëjtë për semestër lidhet me numrin e javëve ku, semestri i I dhe i III kanë më pak javë për shkak edhe të planifikimit të praktikave mësimore. Po ashtu ngarkesa është shpërndarë me kriterin: ngarkesë në auditor dhe jashtë auditorit. GVJ shqyrtoi tabelat e ngarkesës dhe konkludoi që ngarkesa për PAE është si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Pedagogu</th> <th>Norma</th> <th>Ngarkesa fakt</th> <th>Orë suplem.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Prof.Dr. Pal Nikolli</td> <td>140</td> <td>381</td> <td>241</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Prof.AS. Sonila Xhafa</td> <td>140</td> <td>345</td> <td>205</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Prof.AS Sonila Paphimiu</td> <td>140</td> <td>351</td> <td>211</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Dr. Enkela Begu</td> <td>165</td> <td>434</td> <td>269</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	Pedagogu	Norma	Ngarkesa fakt	Orë suplem.	1	Prof.Dr. Pal Nikolli	140	381	241	2	Prof.AS. Sonila Xhafa	140	345	205	3	Prof.AS Sonila Paphimiu	140	351	211	4	Dr. Enkela Begu	165	434	269
Nr	Pedagogu	Norma	Ngarkesa fakt	Orë suplem.																						
1	Prof.Dr. Pal Nikolli	140	381	241																						
2	Prof.AS. Sonila Xhafa	140	345	205																						
3	Prof.AS Sonila Paphimiu	140	351	211																						
4	Dr. Enkela Begu	165	434	269																						

	<p>Siç shihet të gjithë pedagogët e angazhuar si PAE në PS MP “SIG i Aplikuar” janë me orë suplementare më shumë se sa specifikohet në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 të MASR.</p> <p><i>GVJ rekomandon që sasia e orëve suplementare të reduktohet, së paku, deri në 200 orë, që është vlera e përcaktuar nga Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 të MASR.</i></p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton që dizenjimi i kurrikulës përmbajtja e veprimtarive si dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë thellim të njohurive, të aftësive dhe punësimin e studentëve. Këtë na e pohuan vetë studentët gjatë takimit me to. Plotësimin e këtij kriteri e dëshmon gjithashtu edhe punëzënja e të diplomuarve të këtij programi studimesh.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 59, 66, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Lëndët e PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” janë të shpërndara në semestra (gjithsej 4) dhe në vite akademike (gjithsej 2). Në kredite ngarkesa semestrale është si vijon: Semestri I parë 24 ECTS, Semestri II 36 ECTS, Semestri III 24 ECTS dhe Semestri i IV 36 ECTS. Ndërsa ngarkesa vjetore është 60 ECTS për sejcilin vit. Zgjedhja e tipologjisë së lëndëve, shpërndarja e ngarkesës në aktivitete mësimore (leksione, ushtrime/seminare, laboratore/ praktika) si dhe praktika profesionale bashkë me punimin e diplomës i mundësojnë studentit arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të pritshme si të të nxënimit ashtu dhe aftësimin profesional.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 66, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ e konsultoi strukturën e programit, lëndët dhe shpërndarjen e tyre edhe me synim shqyrtimin e raportit teori/praktikë. Ai konstatoi që praktika profesionale ka peshë prej 12 ECTS që përbën 10% të peshës së ngarkesës së studimit, çfarë për programin e studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” konsiderohet normë e pranuar. Me 12 ECTS, duke llogaritur sipas normave Evropiane 25 orë pune të studentit për një ECTS praktikë profesionale, studenti duhet të bëjë 300 orë pune, ose përkthyer në ditë, 37.5 ditë pune ose 2 muaj intensive (derisa semestri zgjatë 15 javë – ose tre muaj). GVJ konsideron se pesha në kredite e punës praktike është shumë e kënaqshme. Duhet theksuar se brenda lëndëve ka edhe punë laboratorike si dhe vizita me karakter profesional, gjë që e rrit efektin e praktikës.</p>



	<i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 66, 68</i>
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Veprimtaritë formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në PS Master Profesional “SIG i Aplikuar”, janë dizenuar konform parashikimeve ligjore në leksione, seminare/ushtrime, punë laborator/praktika në auditor dhe praktikë profesionale e mikrotezë jashtë auditorit. GVJ konsultoi në mënyrë të veçantë kurrikulën e programit dhe syllabuset e lëndëve, inspektoi ambjentet ku zhvillohet mësimi dhe laboratorët, u njoh me marrëveshjet për kryerjen e praktikave profesionale si dhe elementët e mikrotezës dhe konkludon që raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga takimet në institucion me personelin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konkludon se ndryshimet në programet e lëndëve janë të vogla. Pjesëmarrja në projektet e programit ERASMUS+, ku synohet dhe modernizimi i procesit mësimor, mundëson përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të syllabuseve, duke u bazuar dhe në literaturë të detyruar e ndihmëse të 5 viteve të fundit.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Përmbajtjet e lëndëve në programin e studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” sigurojnë mjaftueshëm përfitimin e dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, çfarë kërkohet nga programet e ciklit të dytë master professional.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i>
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Mënyra e organizimit të PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” është konform akteve ligjore e nënligjore të prodhuara për funksionimin e këtij cikli studimesh. Po ashtu, i propozuar për hapje në kuadrin e implementimit të projektit GEOWEB, ai merr në konsideratë përvojat e krijuara nga programet e singjashme në vendet e BE-së. GVJ konsultoi edhe dokumentacionin që lidhet me shkallën e punësimit të studentëve si dhe u informua për pritshmëritë e tyre. Nga të gjitha këto rezulton që ky kriter përmbushet plotësisht.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 35, 63, 68</i>
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e	PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” u mundëson studentëve të marrin njohuri dhe të fitojnë kompetenca profesionale në

mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	procesin e krijimit, administrimit, vlersimit, analizës e vizualizimit të të dhënave hapsinore në mënyrë që ata të krijojnë modele tematike për proceset e dukuritë gjeohapsinore si përdorimi i territorit, planifikimi urban, zhvillimet në sektorin e statistikave, turizmit, kadastrës etj. Duke konsideruar zhvillimet e shpejta dhe të pandërprera në këto fusha, konkludohet që kërkohet studim në vijimësi për punësim në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 35, 63</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Për të realizuar objektivat e programit të studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar”, të hartuara nga UT, angazhohet personeli Administrativ si dhe ai Akademik.</p> <p>Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit.</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” është i përzgjedhur për të përmbushur objektivat e programit. Stafi akademik është i specializuar në fushat përkatëse të shkencës për të dhënë leksionet dhe seminarët e programit, që janë specifike për këtë program. Ai është i trajnuar dhe në kuadrin e realizimit të projekteve GEOWEB dhe GOEBiz.</p> <p>Në evidencat e ofruara nga UT, vërtetohet se lektorët e lëndëve janë me grada shkencore së paku Dr., (vetëm 1 është me kualifikimin Msc).</p> <p>GJV vlerëson gjetjet, edhe gjatë takimeve me pedagogët, se mbulueshmëria e lëndëve në programin e studimit përgjithësisht është me mësimdhënës me grada shkencore Doktor i shkencave</p>

dhe Tituj akademikë Prof.Dr dhe Prof.Assoc. (vetëm 1 PAK është me gradën Msc.)

Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në 3 vitet e fundit, rezulton me të dhënat si më poshtë:

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	1	0	1	0	1	1
Prof.Assoc	2	1	2	3	2	2
Dr/Doc	1	2	1	2	1	2
Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	-	-
Msc	0	1	0	1	0	1
<b>Ne total</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>6</b>

Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës. Nga verifikimi i të dhënave statistikore, ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, sipas të dhënave më poshtë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2019-2020	40 %
2020-2021	40 %
2021-2022	50 %

Nga tabela rezulton që për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, *nuk* është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

Rreth 43.3% është zhvilluar nga PAE dhe pjesa tjetër është përballuar nga stafi me kohë të pjesshme.

	<p><i>GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore të PS Master Profesional "SIG i Aplikuar" të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</i></p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Në këtë PS niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p>I gjithë personeli PAE është trajnuar edhe në kuadrin e realizimit të projekteve GEOWEB e GEOBiz.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 13, 16, 17, 18, 68</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UT (FHF) dhe Departamenti i Gjeografisë kanë të angazhuar personel të kualifikuar dhe me njohuri në fushat e gjeografisë e gjeoinformacionit, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e praktikës profesionale. UT ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet vendore për realizimin e praktikës profesionale (bashkitë Tiranë, Librazhd, Prrrenjas, INSTAT, ASHK, ASHT, ISHP etj)</p> <p><i>GVJ rekomandon rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit edhe me institucione të tjera, të cilat merren me mbledhjen, administrimin, analizën, përpunimin dhe vizualizimin e të dhënave hapsinore.</i></p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidencat: 5, 20, 21, 22, 72.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e Universitetit, përkatësisht laboratorëve, të cilët përdoren nga studentët, u shoqërua dhe u informua nga stafi ndihmës i universitetit (departamentit), i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve. Kishte 2 laboratorë në dispozicion të PS, të paisur në kuadrin e realizimit të projekteve GEOWEB dhe GEOBiz. Mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike ishte në nivel shumë të mirë.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 24</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk ka reagim nga tregu i punës me sugjerime në lidhje me programin e studimit. Ekziston vetëm një korespondencë me ekspertët dhe bashkëpunëtorët për hartimin e kurrikulës dhe syllabuseve. Gjatë takimeve në institucion na u tha që janë në kontakte të vazhdueshme me institucionet bashkëpunuese në kuadrin e projekteve GEOWEB e GEOBiz për përmirësimin e mëtejshëm të PS.  <i>GVJ sugjeron që të planifikohen e të realizon edhe konsulta me aktorët e tregut të punës.</i>  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Në takimet me studentët, GVJ konstatoi që ata ishin shumë të interesuar për mbarëvajtjen e programit dhe shumë të kënaqur me njohuritë e përftuara në kuadër të procesit mësimor. Në takimin me NJSBC mësuam se edhe kjo njësi ishte e interesuar dhe kishte reflektuar ndaj feedback-ut, përcjellë kësaj strukture nga përfaqësuesi i studentëve. Kështu ishte vepruar edhe me hartimin e RVB nga GVB. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstaton që ekziston një listë e studentëve Alumni. Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ u informua për kontaktet që mbahen me studentët Alumni. Këto kontakte mbaheshin nëpërmjet rrjeteve sociale Facebook, Instagram, takimeve periodike dhe gjatë organizimeve të trajnimeve si psh GIS DAY.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 19. 47</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe takimet në institucion, GVJ konstaton që ekziston bashkëpunimi

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 29

private, njësitë e pushtetit vendor etj. institucioni përfitëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor (bashkitë Tiranë, Librazhd, Prrenjas, INSTAT, ASHK, ASHT, ISHP etj) me të cilat përfitëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 22, 47, 72</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UT organizon trajnime të stafit akademik në përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve dhe sipas lëndëve përkatësisht moduleve. Në kuadrin e implementimit të PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” janë zhvilluar seanca të planifikuara trajnimi për Personelin Akademik nëpërmjet shkëmbimeve në linjën e realizimit të projekteve GEOWEB e GEOBiz. Po ashtu institucioni organizon ditët e SIG (GIS Day) ku referohen materiale dhe diskutohen përvoja që lidhen edhe me metodat e mësimdhënjes. Në periudhën e pandemisë, i gjithë personeli akademik është trajnuar në përdorimin e platformës MOODLE për zhvillimin e procesit mësimor on line, dobia e së cilës iu konfirmua GVJ edhe gjatë takimit me studentët. Trajnime të tilla GVJ i gjeti të përfshira edhe në CV e personelit akademik</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 3, 5, 17, 37, 47</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar dokumentacioni të vënë në dispozicion si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që edhe për PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” strukturat përgjegjëse (institucioni, fakulteti dhe departamenti) kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Si organizëm për sigurimin e cilësisë edhe në këtë institucion është ngritur rishtazi (dhjetor 2021) dhe vepron NJSBC e cila, mbështetur në rregulloren e saj, ka për detyrë, që në përfundim të çdo viti akademik të analizojë rezultatet e monitorimit të grupeve të ngritura prej saj dhe këtë analizë t’ja përcjellë senatit akademik dhe bordit të administrimit.</p> <p>Një mekanizim eficient në këtë drejtim është edhe organizimi i anketimeve me studentët. Në takimet e GVJ me personelin akademik dhe me studentët u konstatua që këto mekanizma</p>

	<p>rezultojnë efektive për të diagnostikuar dhe për të përmirësuar cilësinë e PA në mësimdhënie.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 3, 5, 6, 17, 26, 34</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijevë përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në takimet e GVJ me studentët dhe me personelin akademik u konstatua se studentët bëjnë vlerësimin e lëndës dhe cilësinë e stafit sipas kritereve të përcaktuara nga institucioni. Këto vlerësime ishin të pavarura dhe të paanshme. GVJ gjykon që ato kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së veprimtarive akademike. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 6, 17, 26, 34</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ u informua që analiza e rezultateve të pyetsorëve diskutohet privatisht me sejcilin pedagog dhe publikisht në mbledhjen e departamentit. Rezultatet e pyetsorëve u vihen në dispozicion edhe studentëve. Në takimet me pedagogët dhe studentët ata konfirmuan këtë mënyrë të publikimit të rezultateve të vlersimit. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 6, 17, 26, 34</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Si mënyra të promovimit të shembujve e praktikave të mira, nxitjes dhe inkurajimit të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies për këtë PS shërbejnë aktivitete të tilla si mbledhje të departamentit, aktivitete të veçanta si “Ditët e Gjeografisë”, “GIS Day”, leksione të hapura, seminare online etj.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 6, 18, 47, 34</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarat, punët laboratorike,</p>	<p>Për të konkluduar mbi plotësimin e këtij kriteri GVJ konsultoi programin mësimor të PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” si dhe sylabuset e lëndëve. Nga ky konsultim u gjet që format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive në lloje janë: leksionet, seminarat,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 32



<p>detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>punët laboratorike, projektet individuale dhe ato në grup. Këto forma zhvillohen në përputhje me ngarkesën e parashikuar për çdo lëndë dhe sipas përmbajtjes të përcaktuar në syllabuset e lëndëve përkatësisht moduleve. Ato zhvillohen në auditore, laboratore dhe në terren (praktika profesionale) Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet e vëna në dispozicion të mësimdhënjes dhe i gjeti ato funksionale për programin mësimor.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 16, 24, 43</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me personelin akademik konstatohet se përdorimi i metodologjive alternative dhe bashkëkohore në mësimdhënie janë evidente dhe përdoren me përparësi, përditësuar edhe nga pjesmarrjet në projektet në kuadrin e programit ERASMUS+ (GEOWEB dhe GEOBiz). Në takimin me studentët GVJ mësoi se ata ndjehen të “ushqyer” me materiale cilësore, të “përtyqshme” prej tyre në larminë e dhënjes dhe të vlefshme për tregun e punës.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 16, 43</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UT përkatësisht FHF dhe Departamenti i Gjeografisë e mbështetin personelin akademik të PS Master Profesional “SIG i Aplikuar”, në përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike nëpërmjet mobiliteteve akademike (kryesisht edhe në implementimin e projekteve GEOWEB dhe GEOBiz), ftesës së lektorëve të huaj, vënjen në dispozicion të dy laboratorëve me teknologji bashkëkohore të integruar si dhe trajnimeve në kuadër të evenimenteve të posaçme si leksionet e hapura, “Dita e SIG” etj. Efektive në këtë drejtim ka qenë edhe njohja dhe përdorimi i metodave online të mësimdhënjes si platforma MOODLE etj në kohën e pandemisë.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 15, 43, 47</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të</p>	<p>Personeli i angazhuar në Programin e studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” është i mirëkualifikuar në përzgjedhjen e tij, po ashtu dhe i përditësuar në aktivitetin mësimdhënës nëpërmjet trajnimeve brenda e jashtë vendit.</p>

<p>mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Shkalla e përbërjes dhe e kualifikimit të tij paraqitet si vijon: 4 PAE, 4 PAK, 1 Prof Dr., 3 Prof Asoc. 3 Dr.1 Msc. Në këtë kontekst ai është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve si dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 15, 17, 43</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në Programin e studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” studentët përfshihen në përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies nëpërmjet hartimit e realizimit të pyetsorëve nga NjSBC, diskutimit me pedagogë të veçantë sipas lëndëve si dhe reagimeve të tyre në procesin e vlersimeve. Në takimin me studentët, GVJ mësoi se ata janë aktivë në drejtim të mendimdhënies për përmirësimin e formave dhe metodave si dhe pohuan që mendimet dhe sugjerimet e tyre konsiderohen nga autoritetet përgjegjëse dhe personeli akademik.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 6, 26, 34.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>GVJ konstaton që shkalla e kualifikimit të personelit akademik, përmbajtja e kurrikulës, paraqitja e syllabuseve, teknologjia e përdorur si dhe cilësia e studentëve konvergojnë në përdorimin e metodave që i bëjnë tërheqëse dhe eficente orët e mësimit.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 16, 17, 24.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton që në Programin e studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar” format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Për këtë kontribuojnë posaçërisht detyrat dhe projektet individuale në të cilat kërkohet drejtimi i orientuar nga mësimdhënësi si dhe projektet dhe detyrat në grup ku, përpos mësimdhënësit, kontribuojnë edhe studentët pjestarë të grupit. Po ashtu dhe zgjedhja e temave të diplomave dhe realizimi i tyre forcon punën e pavarur të studentit dhe konfirmon vlerën e rolit udhëheqës të personelit akademik. Në realizimin e këtyre detyrave/projekteve ndërtohen edhe marrëdhënie të respektit reciprok midis tyre.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 16, 17, 60, 70</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konsultoi dhe vizitoi hapsirat e vënë në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor për PS Master Profesional “SIG i Aplikuar”.</p> <p>Ai konstaton që këto hapsira janë të mjaftueshme dhe cilësore. Të gjitha sallat e leksioneve e seminarëve në godinën e FHF ishin të paisura me videoprojektorë dhe me akses në internet. Në mënyrë të posaçme, GVJ u interesua për laboratorët e këtij programi studimi, ku gjeti që ato ishin të paisur me teknologjinë e kohës, me paketa programesh të licensuara në përputhje me kërkesat e programit mësimor. Laboratorët kishin kapacitet të mjaftueshëm me poste pune përkatësisht 28 (laboratori 1 salla 329) dhe 15 pozicione pune (lab. 2, salla 328). Të gjitha ambientet ishin të pastra dhe të mirëmbajtura.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 24, 41</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Ambientet e dedikuara për procesin mësimor të PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” ndodhen në godinën e FHF (godina kryesore). Ato janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC (paketa programesh të përgjithshme dhe të lidhura me programin e studimit), video projektor, internet (ëireless), ndriçim alternativ dhe sistem kondicionimi.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 24, 41</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët, në mjediset e vëna në dispozicion, shfrytëzojnë programet e përgjithshme të Windoës si dhe programe të dedikuara që lidhen me programin mësimor (ArsGIS etj). Këto të fundit janë të instaluar në PC e vendosura në laboratore.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 24, 41</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Studentëve të këtij programi studimi literatura bazë e domosdoshme u jepet kryesisht në formën e teksteve mësimore dhe leksioneve të shkruara, të cilët listohen tek përmbajtja e syllabuseve për të gjitha lëndët, përkatësisht modulet. Po ashtu në syllabuse listohet edhe literature e rekomanduar kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Tituj të rëndësishëm të kësaj literature gjendeshin në bibliotekën e fakultetit.</p> <p><i>GVJ rekomandon pasurimin me tituj të kësaj biblioteke dhe përditësimin periodik të literaturës.</i></p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 16, 25</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në materialin e vënë në dispozicion lista e titujve që lidhen më PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” dhe që ndodhen në bibliotekën e institucionit është relativisht e pakët (18 tituj) dhe tërësisht në gjuhën shqipe. Gjatë vizitës në bibliotekën e fakultetit, GVJ konstatoi që ajo ishte e sistemuar mirë, me indeksim të qartë, e aksesueshme në PC, me hapsira të bollshme e kushte të mira studimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e titujve të orientur në këtë program studimi, pasurimin me tituj në gjuhë të huaj dhe krijimin e mundësisë për të aksesuar literaturën në biblioteka online (e-library) etj</i></p> <p>RVB. Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 25.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që, për këtë program studimi, akoma nuk është mundësuar aksesimi i literaturës në bibliotekën online nga ana e studentëve. Ato asistohen nga pedagogët kur shfrytëzojnë aksesimin online të literaturës, pasi pedagogët e kanë këtë mundësi.</p> <p><i>GVJ rekomandon që kjo mundësi t’u afrohet sa më shpejt dhe me sa më shumë cilësi edhe studentëve.</i></p> <p>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor në Master Profesional “SIG i Aplikuar” janë ngritur e paisur dy laboratore. Pozicionet e punës në këto laboratore janë përkatësisht 28 dhe 15, të mjaftueshëm për studentët e këtij programi. Laboratorët janë ngritur në kuadrin e modernizimit të procesit mësimor me mbështetjen financiare e logjistike të projekteve GEOWEB e GEOBiz. Në takimin me studentët, GVJ mësoi se ata i shfrytëzonin laboratorët jo vetëm në kohën e</p>

	<p>parashikuar në planin mësimor por edhe jashtë saj për të zgjidhur projekte në kuadrin e praktikave profesionale e temave të diplomave. Të gjitha programet e instaluar në kompjuterat e laboratorëve ishin të licensuar.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 16, 24.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në PM Master Profesional “SIG i Aplikuar” personeli akademik përdor platformën on-line Teams, Google Classroom, MOODLE etj. Të gjithë pedagogët dhe studentët ishin trajnuar për përdorimin e këtyre platformave kryesisht gjatë kohës së pandemisë, por ato vazhdojnë të përdoren akoma, duke u kombinuar me mësimin në auditor, për të shpërndarë literaturën, leksionet, udhëzimet për detyrat ose projektetet si dhe për komunikime individuale me studentët.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 8</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion, GVJ mësoi që me fillimin e vitit akademik 2022-2023 është parashikuar të krijohet e të funksionojë sistemi i komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p> <p><i>GVJ rekomandon krijimin dhe funksionimin sa më të shpejtë të këtij sistemi, pasi përvoja nga institucionet e tjera tregon se ai është mjaft i dobishëm si në procesin akademik ashtu edhe në drejtimin administrativ.</i></p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 8</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në programin mësimor Master Profesional “SIG i Aplikuar” departamenti, një muaj nga dita e fillimit të vitit të dytë akademik, u ofron studentëve të këtij viti temat e diplomave, të cilat formulohen nëpërmjet konsultimeve të pedagogëve titullarë të lëndëve me studentët. Pas kësaj, këta të fundit zgjedhin temën e diplomës, udhëheqjen e së cilës e merr përsipër titullari i lëndës. Në realizmin e temës punën e studentit e asiston dhe e mbështet pedagogu udhëheqës.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 3, 4, 5</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në përputhje me objektivat strategjike të institucionit, UT përcakton në Statut dhe rregullore, prioritetin për sigurimin e cilësisë, si dhe ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjal).</p> <p>NJSBC është organi që bashkërendon veprimtarinë e vet me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet, në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Departamenti Gjeografisë ka përcaktuar koordinatore të programit të cilët, në bashkëpunim me NJSBC, e mbikqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikqyrja bëhen edhe nga departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me NJSBC. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparura në mësimdhënie dhe mësimnxënie. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 3,4, 5,6</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>FHF dhe Departamenti i Gjeografisë janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në programin e studimit Master Profesional “SIG i Aplikuar”. Anëtarët e departamentit dhe fakultetit trajnohen vazhdimisht nga NJSBC dhe ekspertët e jashtëm të kontraktuar me këtë qëllim. Eksperienca e fituar ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe fushën e sigurimit të cilësisë. Strukturat, nëpërmjet pyetsorëve, nxisin studentët që të jenë pjesë e procesit të evidentimit dhe përmirësimin të cilësisë në mësimdhënie. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 3,4, 5,6</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Gjeografisë ushtron kontrole të vazhdueshme nëpërmjet hartimit, realizimit dhe vlersimit të pyetsorëve lidhur me cilësinë dhe efektivitetin e mësimdhënies. Nëpërmjet këtyre pyetsorëve tërhiqet mendimi i studentëve për vlersimin tërësor të procesit të mësimin si dhe vlersimi i metodave të reja. Në takimin me studentët, GVJ mësoi se ata i vlersonin metodat e përdorura. Ata na informuan edhe mbi dobinë e platformave të përdorura për zhvillimin e mësimin online. Pedagogët e këtij programi, nëpërmjet trajnimeve në kuadrin e projekteve GEOWEB e GEOBiz, kanë përdorur metoda të</p>

	reja mësimdhënie, të cilat kanë patur pritje të mirë në ambientet e mësimdhënjes. Përvoja e fituar në këtë drejtim është përhapur edhe nëpërmjet leksioneve të hapura, seminareve, bisedave e diskutimeve midis personelit akademik etj. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 26, 47</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ u informua mbi nivelin aktual të personelit akademik dhe atij mbështetës. Për mësimdhënien në PS Master Profesional “SIG i Aplikuar” në vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar si personel akademik 1 Prof.Dr. 3 Prof. Asoc.Dr, 3 Dr. dhe 1 Msc.  GVJ konsultoi CV e tyre dhe konkludon që ata kanë arritje të vazhdueshme në fushën e kualifikimit dhe, me angazhimin e tyre në aktivitetet e kërkimit shkencor dhe botimeve, synojnë arritje të mëtejshme çfarë do ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 5, 15, 17, 18</i>
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitet përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në CV e personelit akademik dhe atij mbështetës konstatohet që UT, FHF dhe Departamenti i Gjeografisë e kanë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme atë, çfarë ka si rezultat edhe titujt e gradat shkencore që ata zotërojnë. Me këtë nivel kualifikimi trupa mësimdhënëse garanton përmirësim të aftësive në procesin mësimor dhe rritjen e mundësisë për implementim e metodave të reja. Në kuadrin e konkurimit si institucion, është siguruar pjesmarrja në projektet GEOWEB dhe GEOBiz nëpërmjet së cilës është kryer edhe trajnimi i pothuajse të gjithë personelit në drejtim të modernizimit të procesit mësimor. Dëshmi për këtë janë edhe kërkesat për paisjen e laboratorëve të GIS. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 7, 15, 17, 18, 57</i>
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Në kontratat e punës të personeli akademik e ndihmës akademik janë sanksionuar detyrimet e tyre. Detyrimi kryesor është angazhimi në procesim mësimor dhe atë kërkimor-shkencor. Në zbatim të detyrimeve kontraktuale, gjithë trupa mësimdhënëse realizon ngarkesën mësimore nëpërmjet veprimtarive mësimore duke përmirësuar metodat ekzistuese dhe duke implementuar metoda të reja. Në takimin me trupën akademike, GVJ u informua për mënyrat e mësimdhënjes që përdoren prej saj, ndërsa në takimin me studentët ai mësoi mbi

	efektivitetin e përdorimit të tyre. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 15, 17, 18</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë zhvillimit të aktiviteteve mësimore, në gjithë llojshmërinë e tyre, personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik i këtij program studimi, testojnë metoda të reja mësimdhënie kryesisht nëpërmjet futjes së teknologjisë së informacionit. Një kontribut në këtë drejtim jep edhe teknologjia e re e paisjes së laboratorëve të GIS. Nëpërmjet përdorimit të saj rritet interaktiviteti dhe inovacioni në procesin mësimor. Risitë në këtë drejtim i pohuan edhe studentët në takimin që zhvilloi GVJ me to.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 18, 24, 26, 47, 57</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	UT si institucion, FHF si njësi kryesore dhe Departamenti i Gjeografisë si njësi përgjegjëse për programin e studimit MP “SIG i Aplikuar” marrin nga partnerët e tyre, kryesisht nga UPT, pedagogë që angazhohen për zhvillimin e procesit mësimor. Në kuadrin e zbatimit të projektit GEOWEB kanë bashkëpunuar me stafin e këtij PS edhe pedagogët e departamenti të Gjeodezisë dhe ato të Departamentit të Inxhinierisë Minerare (UPT). Po kështu, në aktivitete të ndryshme si psh “Ditët e SIG” kanë marrë pjesë e kanë referuar edhe të ftuar nga institucione partnere. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 18, 47, 57</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 40



	<p>Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i konsultojnë në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton te jetë:</p> <p>Frekuentimi në masën 70% i seminareve dhe ushtrimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 % aktivizimi në seminare;</li> <li>- 10 % vlersimi në testin e parë që zhvillohet në javën e 6-të;</li> <li>- 10 % vlersimi në testin e dytë që zhvillohet në javën e 10-të;</li> <li>- 20% shlyerja e detyrave të kursit;</li> <li>- 50 % provimi përfundimtar;</li> </ul> <p>GVJ konstaton se kjo përqindje e pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët është gjithëkontrolluese dhe kontribuon në përvetësimin e përmbajtjes së lëndëve përkatësisht moduleve.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2, 4, 5, 16</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ mësoi që studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2, 4, 5, 16</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Për PS MP “SIG i Aplikuar” testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja active;</li> <li>• frekuentimi i detyrueshëm i seminareve dhe ushtrimeve në masën 70 %;</li> <li>• plotësimi i detyrimeve mësimore (laboratore, detyra kursi);</li> <li>• pjesmarrja në provimet e ndërmjetme (2) dhe provimin përfundimtar;</li> <li>• dorëzimi dhe mbrojtja e mikrotezës;</li> </ul>

	Informimi dhe sqarimi i studentëve për mënyrat dhe masën e vlersimit bëhet edhe nga tutorët përkatës, që caktohen për çdo program studimi. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2, 4, 5, 16</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.6

**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Për testimin dhe vlersimin e dijeve në Programin mësimor MP “SIG i Aplikuar, përdoren format e përcaktuara në Rregulloren e UT-së dhe të Programit të studimit. Këto forma janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja active;</li> <li>• frekuentimi i detyrueshëm i seminareve dhe ushtrimeve në masën 70 %;</li> <li>• plotësimi i detyrimeve mësimore (laboratore, detyra kursi);</li> <li>• pjesmarrja në provimet e ndërmjetme (2) dhe provimin përfundimtar;</li> <li>• dorëzimi dhe mbrojtja e mikrotezës;</li> </ul> <p>Masa e vlersimit është përcaktuar në rregulloret e përmendura dhe përmbahet në syllabusin e çdo lënde. Ajo jepet në përqindjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 % aktivizimi në seminare;</li> <li>- 10 % Vlersimi në testin e parë që zhvillohet në javën e 6-të ;</li> <li>- 10 % Vlersimi në testin e dytë që zhvillohet në javën e 10-të;</li> <li>- 20% Shlyerja e detyrave të kursit;</li> <li>- 50 % provimi përfundimtar;</li> </ul>

	<p>Këto tregues dëshmojnë që testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 4, 5, 16</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstatoi që, për këtë program studimi, nuk ka sistem elektronik testimi dhe vlersimi të posaçëm. Vlersimi studentëve u komunikohet në mënyrë konfidenciale nga pedagogu nëpërmjet platformës TEAMS. Me fillimin e vitit akademik 2022-2023 është parashikuar të krijohet e të funksionojë sistemi i komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar (e-student).</p> <p><i>GVJ rekomandon krijimin dhe funksionimin sa më të shpejtë të këtij sistemi, pasi përvoja nga institucionet e tjera tregon se ai është mjaft i dobishëm në si në procesin akademik ashtu edhe në drejtimin administrative.</i></p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri zbatohet detyrimi i përcaktuar në rregulloret përkatëse. Vlerësim përfundimtar bëhet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamenti dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2,4,5</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Testimi dhe vlersimi i njohurive e dijeve edhe për këtë PS zhvillohet në mënyrë anonime, me sekretim në çdo fund semestri. Sekretimi bëhet nga sekretaria mësimore e cila ruan anonimat në kushtet e vlersimit nga pedagogu. Pas vlersimit studenti njihet me rezultatin dhe ka të drejtën e ankimit sipas dispozitave ligjore të institucionit.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ mësoi se procedurat e ndjekura për testimin dhe vlersimin zbatohen në përputhje me përcaktimet ligjore. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2,4,5, 7</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të</p>	<p>Në takimin që GVJ zhvilloi me sekretarinë mësimore mësoi që vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për çdo rast i bëhet e ditur studentit duke i dhënë shpjegime për përgjigjet dhe duke e bindur atë që vlersimi është i drejtë. Gjatë diskutimeve të tilla pedagogu i tregon studentit çfarë</p>

<p>nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>është bërë gabim dhe si duhej bërë që përgjigja të ishte e saktë. Në këtë process studentin ndihmohet që të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2,4,5, 7</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në të gjitha testet dhe mënyrat e vlerësimit pedagogu (në rastin e detyrave të kursit, punëve laboratorike, realcioneve të praktikës profesionale) apo komisioni (në rastin e provimeve të lëndëve, mbrojtjes së mikrotezës) shqyrton përgjigjet edhe me përgjegjësinë për të evituar plagjiaturën përkatësisht kopjimin. Në rast të konstatimit studentin vlerësohet negativisht dhe është i detyruar të përsërisë punimin përkatësisht provimin.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2,4,5, 7</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulet kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga platforma TEAMS, ose edhe me komunikim verbal dhe individual nga ana e pedagogut. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigohet nga komisioni dhe brenda 5 ditëve. Studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit TEAMS. Pas marrjes së vlerësimit pedagogu i lëndës, me kërkesën e studentit, bën shpjegimet lidhur me vlerësimin. Gjate vitit pedagogët janë të lirë të kombinojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2,4,5, 7</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në takimin me studentet, GVJ konstatoi që ata njohin të drejtën e tyre për ankimim. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studentin ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studentin, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Mbas kësaj faze, sërish studentin ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2,4,5, 7</i></p>

<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në kushtet e kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim i dorëzohet Përgjegjësit të Departamentit i cili e shqyrton aatë dhe ia përcjell pedagogut të lëndës, i cili është i detyruar të japë shpjegimet përkatëse. Mbas kësaj faze, nëse sërish studenti nuk bindet për vlersimin atëhere kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë i cili konfirmon vlersimin ose urdhëron rishlyerjen e detyrimit.</p>			
<p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 2,4,5, 7</i></p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
<p>X</p>				

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimi MP”SIG i aplikuar” zhvillohet mbi bazën e një kurrikule të hartuar nga një staf i kualifikuar dhe i trajnuar në kuadrin e implementimit të projektit GEOWEB (Programi Erasmus +). Në këtë kuptim ajo merr në konsideratë standardet europiane që kërkohen për hartimin e një kurrikule duke garantuar thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 4,5, 13</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar kurrikulës së programit të studimi MP”SIG i aplikuar” konstatohet që ajo përmban lëndë/module të tilla si “Përftimi të dhënave hapsinore”, “Web GIS’ etj, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Po ashtu, në planin mësimor të programit ka lëndë si “Vendimmarrja hapësinore”, “Planifikimi dhe menaxhimi i Mjedisit dhe Trashëgimisë”, “GIS Turizëm” etj, të cilat përcjellin tek studentët edhe vlera humanizmi, sociale, komunikimi e ndërveprimi.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e</p>	<p>Qysh në fillim të zhvillimit të programit të lëndës, studenti njihet me përmbajtjen e syllabusit të hartuar nga titullari i lëndës. Në realizim të programit mësimor, për çdo lëndë të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 45

<p>studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>veçantë, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në testet dhe vlersimet përkatëse, në diskutimet për to si dhe duke tërhequr vlerësimet e të diplomuarve e të punësuarve në këtë PS. Mbi këtë bazë bëhen edhe plotësimet e përmirësimet në syllabuse në masën deri 20%. Për PS MP”SIG i aplikuar”, për shkak të kohës së shkurtër nga fillimi (viti 2018-2019), ndryshimet në planin mësimor dhe në syllabuse janë të pakta.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 16.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion (takimet me personelin akademik dhe studentët), GVJ konstaton që në përfundim të çdo moduli përkatësisht lënde, nga personeli akademik janë evidentuar çështjet më të rëndësishme të trajtuara si dhe janë orientuar studentët në problematikat më të rëndësishme për të realizuar me sukses testin përfundimtar. Ky konkluzion nxirret edhe nga cilësia e notës mesatare, por edhe nga shkalla e lartë e punëzënjes së të diplomuarve në përputhje me programin e studimit. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 13, 16, 18, 26</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në plotësim të këtij kriteri, GVJ konsultoi evidencën “<i>Veprimtaritë shkencore dhe ngarkesën mësimore për vitin 2020-2021</i>”, dhe gjeti plot aktivitete të personelit akademik që dëshmonin veprimtari jashtë strukturës së programit të studimit. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm ishte dhe “Ditët e GIS” ku personeli akademik efektiv dhe i ftuar ka referuar mbi zhvillimet më të reja të shkencës dhe teknologjisë. Ky aktivitet zhvillohet çdo vit dhe mbështetet nga ESRI (Environmental Systems Research Institute) e cila publikon dhe promovon programet kompjuterike (ArcGIS) të hartuara dhe prodhuara prej saj. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidenca 17, 18, 47.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri shërben shqyrtimi i aktivitetit që zhvillohet në laboratorët e programit. GVJ konstatoi që laboratorët e vënë në dispozicion të këtij PS ishin të paisur me programet më të fundit që përdoren për GIS-in e aplikuar. Përdorimi i tyre u jep mundësi studentëve të zhvillojnë e konkretizojnë njohuritë e marra në të gjitha lëndët që karakterizojnë programin. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidenca 16, 24, 34</i></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Duke konsultuar planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton që zhvillimi i detyrave apo projekteve kërkon punën në grup, e cila mbështetet nga personeli akademik i ngarkuar me zhvillimin e këtij programi si dhe realizohet nga studentët e tij. Në takimin me studentët ata u shprehën të arrirë me funksionimin e punës në grup si dhe evidentuan kontributin e pedagogëve në realizimin me sukses të saj.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidenca 13, 16.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Në të gjitha mjediset e realizimit të PS MP “SIG i Aplikuar” krijohet klimë e përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe studimeve kërkimore duke mbledhur, administruar, vlerësuar, analizuar e vizualizuar të dhëna që shërbejnë në krijim modelesh për fenomenet e proceset gjeohapsinore. Ndërtimi i këtyre modeleve, të tematizuar sipas problematikës, të realizuar me anë të programeve në laboratorët e GIS, në analizë dhe interpretim çon tek zbulime të ligjësive me interes për përdorimin në tregun e punës.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidenca 13, 16, 18.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë gjithë procesit mësimor studentët e këtij programi angazhohen në modelim të dhënash konkrete për zgjidhjen e detyrave, projekteve dhe punimeve të diplomave. Në këto angazhime ata mbështeten nga institucioni nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte si ai GEOWEB, “Ditët e SIG” dhe financimeve në paisjen me teknologji bashkëkohore.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion, Evidenca 47.</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton që për PS MP “SIG i Aplikuar, kontributi i personelit akademik në ndërthurjen e formave të mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve jepet nëpërmjet realizimit të projekteve GEOWEB dhe GEOBiz si dhe në koordinimin, bashkërendimin dhe kryerjen e praktikës profesionale. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.8**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>UT si institucion, FHF dhe Departamenti i Gjeografisë si njësi përgjegjëse për PS MP “SIG i Aplikuar” kanë vënë në dispozicion të tij ambiente të përshtatshme si për realizimin e praktikës laboratorike ashtu edhe të asaj profesionale. Për të parën ekzistojnë 2 laboratore të quajtur laboratorët e GIS, në të cilët ofrohen përkatësisht 28 dhe 15 pozicione pune, të paisura me teknologjinë e kohës.</p> <p>Për kryerjen e praktikave profesionale në këtë PS, UT ka kontraktuar institucione të tilla si bashkitë Tiranë, Librazhd e Prrenjas, INSTAT, ASHK, ISHP, AKT etj. GVJ konsultoi marrvëshjet e lidhura me këto institucione dhe konkludon në plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 21, 22, 24</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Zhvillimi i praktikave profesionale për PM MP “SIG i Aplikuar” bëhet në ambientet jashtë institucionit. Në këto ambiente ekzistojnë zyra përkatësisht struktura që merren me mbledhjen, administrimin, analizën, vlersimin dhe vizualizimin e të dhënave hapsinore. Të tilla kanë bashkitë si dhe institucionet kombëtare si INSTAT, ASHK, ISHP, AKT etj. UT ka lidhur marrëveshje me këto institucione dhe në kuadrin e zbatimit të tyre kryhet praktika profesionale. Ajo mbikqyret nga pedagogë të cilët ndjekin në mënyrë sistematike mbarëvajtjenn e saj pranë institucioneve të kontraktuara, ndihmojnë dhe këshillojnë studentin gjatë mbledhjes e përpunimit të të dhënave dhe në hartimin e projektit profesional. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 21, 22, 24</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Në plotësim të këtij kriteri GVJ konsultoi planin mësimor dhe konstatoi që praktika profesionale për PM MP “SIG i Aplikuar” ka në dispozicion 12 kredite ECTS (10% e ngarkesës së përgjithshme). Realizimi i praktikës dëshmohet me hartimin e një projekti profesional, i cili vlerësohet nga pedagogu që mbikqyr praktikën.</p> <p><i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 21, 22, 24</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në aktet ligjore e nënligjore të UT përcaktohen qartësisht procedurat për provimin final përkatësisht mbrojtjen e diplomave. Për PM MP në "SIG i Aplikuar" rregulloret parashikojnë si mbrotje të diplomës ashtu edhe provim të përgjithshëm përfundimtar. Rezultatet e këtij vlersimi mbahen nga sekretaria mësimore në një regjistër, modeli i të cilit është përcaktuar nga MASR. Diplomat mbrohen para një komisioni të përcaktuar me propozim të Shefit të Departamentit dhe të miratuar nga Dekani, kurse Përovimi i Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) bëhet me shkrim. Edhe në këtë rast teza hartohet nga një komision i posaçëm. Vlersimi për pyetjet bëhet nga titullarët e lëndëve referuar sasisë së përgjithshme të pikëve të vëna në dispozicion të lëndës. Mbrojtja e diplomave publikohet në internet në faqen e FHF (Departamenti i Gjeografisë) dhe afishohet në ambientet e fakultetit. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 4, 5</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Për mbrojtjen e diplomës dhe dhënien e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar studentëve u duhen informacione, udhëzime si dhe të dhëna të personalizuar apo të përgjithshme. Të gjitha këto materiale atyre u vihen në dispozicion si gjatë kohës së procesit mësimor ashtu edhe në kohën e përgaditjes për vlerësim. Sipas specifikave të lëndëve apo temave të diplomave dërgohen edhe materiale plotësuese në shërbim të një përgaditje sa më produktive. Për këtë përdoren platforma TEAMS, posta elektronike etj. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 4, 5, 7.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri</p>	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final propozohet nga Departamenti dhe miratohet nga Dekani. Ai ka në përbërje të tij pedagogë nga disiplinat kryesore të programit. Ky komision përgadit tezën duke marrë në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 49

viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	konsideratë përfshirjen e njohurive nga të gjitha lëndët karakterizuese dhe/ose ndërvepruese/integruese të programit sipas peshës së tyre në kredite. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 4, 5</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Personeli akademik i PS MP “SIG i Aplikuar” orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave diplomave duke ofruar fushat dhe formuluar temat. Studentët kanë të drejtë të zgjedhin temën dhe pedagogun udhëheqës. Ata gjejnë dakordësinë midis tyre. Udhëheqësi e konsulton diplomantin sa herë ai ka nevojë për këshilla dhe udhëzime. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca: 4, 5, 23</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në programin e studimit MP “SIG i Aplikuar” studentët diplomantë kanë nevojë të mbledhin të dhënat, kryesisht nga institucionet që i disponojnë ato (INSTAT, ASHK, AKT, ISHP etj), ti përpunojnë, analizojnë, vlersojnë dhe modelojnë ato. Për të realizuar përpunimin, analizën, vlersësimin dhe modelimin e të dhënave studentët shfrytëzojnë laboratorët e programit të studimit, të cilat disponojnë programet e duhura. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Në programin e studimit MP “SIG i Aplikuar” studentët diplomantë udhëhiqen nga pedagogë të cilët kanë për detyrë ta orientojnë studentin për krijimin e bazës së nevojshme teorike, e cila do ta ndihmojë atë në interpretimin sa më profesional të rezultateve si dhe krijimin e një baze të dhënash të lidhur sa më ngushtë me objektivat e temës së diplomës. Në çdo rast studenti konsultohet me pedagogun udhëheqës në kërkim të zgjidhjeve që synon të realizojë. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 5</i>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Ky kriter plotësohet sipas përcaktimeve ligjore për vlersimin në Universitetin e Tiranës. Nota vendoset nga Komisioni i Diplomimit në rastin e vlersimit të diplomës dhe nga pedagogët e lëndëve në rastin e PPP. Për këtë të fundit merret në konsideratë pesha që zënë lëndët e veçanta në formimin e përgjithshëm. <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 5</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga	Në përfundim të studimeve në PS MP “SIG i Aplikuar” studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës në zbatim të përcaktimeve ligjore të institucionit.

ministrira përgjegjëse për arsimin.	<i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 4, 5, 23.</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Plotësimi i këtij kriteri për PS MP “SIG i Aplikuar” përmbushet, pasi në suplementin e diplomës përmbahet një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Ky suplement u jepet të gjithë të diplomuarve në këtë program studimi.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	I gjithë dokumentacioni zyrtar i prodhuar për çdo student ruhet pas diplomimit në arkivin e institucionit dhe më pas trajtohet sipas ligjit për arkivat. Institucioni arkivon dokumentacionin e studentit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.  <i>RVB, Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 4, 5</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>																																																														
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>																																																														
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																																																													
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e institucionit për angazhimin e personelit akademik janë dhënë për një periudhë kohore 3-vjeçare, respektivisht për vitet akademike:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>VA.2019-2020</li> <li>VA.2020-2021</li> <li>VA.2021-2022</li> </ol>																																																													
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit</th> <th colspan="2">Viti akademik 2021-2022</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> <th colspan="2">Viti akademik 2019-2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr/Doc</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr në proces)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td><b>Ne total</b></td> <td><b>4</b></td> <td><b>5</b></td> <td><b>4</b></td> <td><b>6</b></td> <td><b>4</b></td> <td><b>6</b></td> </tr> </tbody> </table>		Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	1	0	1	-	Prof.Assoc	2	2	2	2	2	3	Dr/Doc	1	2	1	2	1	2	Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	-	-	Msc	0	1	0	2	0	1	<b>Ne total</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>6</b>					
	Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020																																																								
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																							
	Prof. Dr	1	-	1	0	1	-																																																							
	Prof.Assoc	2	2	2	2	2	3																																																							
	Dr/Doc	1	2	1	2	1	2																																																							
	Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	-	-																																																							
Msc	0	1	0	2	0	1																																																								
<b>Ne total</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>6</b>																																																								
<p><i>Nga të dhënat GVJ konstaton se, numri i personelit akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në këtë program studimi është i njëjtë për periudhën tri vjeçare 2019-2022 dhe në përputhje me profilin e programit të studimit në të cilin kontribuojnë. Gjithashtu në të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni jepet informacion edhe për angazhimin në procesin e mësimdhënies së çdo anëtari të DHGJ sipas semestrave dhe vitit akademik. Krahas personelit akademik efektiv, për realizimin e objektivave të programit të studimit ushtrojnë detyren edhe koordinatoresja e programit edhe një personel ndihmës akademik.</i></p>																																																														

	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij program studimi. <i>Evidenca 17, 20, 68, Vizita në Institucion në zyrën e burimeve njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>DGJ në FHF, të UT kryen procedurë për rekrutimin e personelit akademik të përcaktuar sipas përcaktimeve të <b>Statutit të UT, neni 67 “Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë” dhe Rregullores së UT, neni 25 “Përzgjedhja dhe emërimi i personelit me kohë të plotë të.</b></p> <p>Punësimi në UT bëhet bazuar në legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe nënligjore të Arsimit të Lartë në RSH dhe statutin e UT. Ai realizohet me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për personel akademik propozohen nga departamenti përkatës. Nëse, pas verifikimit dekani i njësisë kryesore shpreh dakortesinë kryen shpalljen e vendeve të lira të punës dhe drejtuesi i FHF ia përcjell për miratim Rektorit. Kriteret për rekrutim të personelit akademik janë të klasifikuara në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kriete të përgjithëshme;</li> <li>2. Kriete Specifike të prpzuara nga departamenti Satuti;</li> </ol> <p>Fazat e procedures së rekrutimit referuar Statutit të UT janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>A. Njësia kryesore kryen shpalljen në faqen zyrtare në internet;</li> <li>B. Drejtuesi i njësisë kryesore ngre një komision ad hoc për përzgjedhjen e knadidatëve fitues;</li> <li>C. Komisioni përbëhet nga pesë anëtar të përsoneelit akademik të kategorisë Profesor (dy përfaqësues të zgjedhur nga Për/dep, dy përfaqësues të zgjedhur nga Dekani dhe një nga rektori);</li> <li>D. Komisioni bënë verifikimin e kandidatëve që përmbushin kriteret e përgjithëshme dhe specifike;</li> <li>E. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza:</li> </ol>

	<p>a. Vlerësimi i dosjes;</p> <p>b. Intervista;</p> <p>F. Kandidatët që kalojnë vlerësimin e dosjes i nënshtohen procesit të intervistimit;</p> <p>G. Brenda tri ditëve komisioni shpall listën e kandidatëve fitues sipas vlerësimit të marrë;</p> <p>Lista kalon më pas për miratim nga Rektori brenda dhjetë ditëve. Gjatë vizitës në institucion, në takim me Drejtoreshën e Zyrës së Burimeve njerëzore të FHF u shpjeguan prej saj kriteret që përdorshin për rekrutimim e personelit akademik të propozuar nga DGJ në funksion të programit të studimit MP në “SIG i Aplikuar” dhe hapat e procesit të rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm. Konkretisht u njohëm me dosjet e aplikantëve dhe procedurat e kryera nga komisionet ad hoc, të ngritura për këtë qëllim. GVJ kreu kontrollin e një praktike të rastësishme dhe konkludoi që praktika ishte korrekte në përputhje me deklaratimet e dokumentacionit dhe deklarimit të drejtuesit të BNJ në FHF. <i>Evidencat: 4, 2, Minutat e takimeve për MP në “SIG I Aplikuar”</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Departamenti i Gjeografisë nëpërmjet koordinorit të programit të studimit MP në “SIG i Aplikuar” i cili sipas nenit 16 “Koordinatori I MP- SIG i Aplikuar”, pika j ka përgjegjësinë ti paraqes Komitetit Shkencor si organ dejtues i programit të studimit, kriteret e pranimit dhe kandidaturat per personel akademik dhe ndihmës dhe pas miratimit dhe përzgjedhjes prej tij i kalon për miratim Përgjegjësit të Departamentit. Pas miratimit nga Përgjegjësi i Departamentit, Dekani dhe më pas nga Rektori, drejtuesi i FHF i shpall ato edhe në faqen zyrtare të FHF. Neni 67, pika 4 i statutit të UT. <i>Evidencat: 5, 2, 4.</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurën me katër faza.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në fazën e pare, kryhet shpallja e pozicionit të lirë të punës</li> <li>2. Në fazën e dytë vlerësimi me dosje duke krijuar një databazë të aplikantëve;</li> </ol>

përmbajtjen e programit të studimit.

3. Në fazën e tretë kryhet vlerësimi paraprak i aplikantëve nga një komision i përbërë nga Komisioni ad hoc;

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

Kritere të përgjithëshme;

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- Të ketë përfunduar studimet Master Shkencor dhe/ose të doktoratës në të njëjtën fushë;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje nga gjykata;
- Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore;

Kriteret specifike janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit MP-SIG i Aplikuar si: Personeli akademik që jep mësim në këtë program duhet të zotërojë titullin Profesor, Professor i asociuar, gradën Doktor ose doktoraturë në process.

GVj konstatoi në kontrollin e dosjeve të aplikantëve që këto kritere zbatoheshin me korrektësi.

*Evidenca 2; 5. Takimi me Drejtuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të FHF; Takimi me koordinatoren e Programit të Studimit, RVB.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të	UT, FHF ka mjedis të përshtatshëm për realizimin e detyrave të personelit. Ambjentet e punës janë të paisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana

<p>përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>e personelit akademik. Në fondin e bibliotekës së FHF gjendet një fond i dedikuar vetëm për fushën ku zhvillohet programi i studimit MP-SIG i Aplikuar me autorë të huaj. Titujt e librave janë të rekomanduar nga personeli akademik që punon për programin e studimit MP-SIG i Aplikuar.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GJV u njoh konkretisht me këtë fond dhe nga ballafaqimi konsatoi se titujt e librave janë në përputhje jo vetëm me dokumentacionin por edhe në përputhje me objektivat lëndorë të lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin mësimor të ciklit të dytë MP në SIG i Aplikuar. Disa prej botimeve ishin përshtatje të botimeve më të mira të pesë viteve të fundit në këtë fushë, të realizuara nga personeli akademik që angazhot në këtë program studimi. <i>Evidenca 10, 25, Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit tregoi se institucioni realizon disa nisma të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Staf i përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete në kuadër të programit Erasmus + etj. Institucioni mbështet përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor stafin akademik që realizon botime të artikujve shkencor të indeksuara në Scopus.</p> <p>Nga ballafaqimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion GJV konstatoi se personeli akademik i angazhaur në program ka përfituar nga praktikat për trainimin e stafit nga programi ERASMUS+ dhe projekte europiane që kanë në focus GIS technology, informacionit gjeohapsinor, Gis, Mine Surveying, Geodesy, Geomatics.</p> <p>Shkalla e përfshirjes në projekte është realizuar nga i gjithë personeli akademik efektiv dhe me kontrate. Gjatë vizitës në institucion nga anëtarët e GVB u konfirmua mbështetja financiare e institucionit të pjesmarrjes së stafit në ngjarje shkencore ndërkombëtare dhe projekte nderkombetare.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit</p>	<p>Nga dokumentacioni shoqerues evidentohet pjesmarrja e stafit akademik në trainime mbi mësimin elektronik dhe mësimin e bazuar mbi probleme të organizaur në kuadër të projektit GEOWEB të financuar nga program Erasmus +, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu marrja pjesë e stafit në programet Erasmus + krijon mundësi për të përfituar nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni mundëson dhe trajnimin e stafit akademik nga</p>



akademik e të personelit mësimor-shkencor.	zyra e Agjencia e Kërkimit dhe Teknologjisë së Informacionit, Zyra Erasmus + në Tiranë, etj. Evidenca: 69, 17, 43			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<p>Institucioni dëshmon për përpjekje serioze për përmbushjen e objektivave në mbulimin e programit me staf akademik me tituj dhe grada shkencore. Përgjatë vitit 2020-2021 personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në program ka qënë: 1Prof. Dr dhe 2 Prof.Assoc 1 Dr, ndërsa si lektor me kontrate ka rekrutuar 2 me titull Profesor i Asociuar dhe 2 me gradën Dr. Formimi profesional i personelit akademik është në përputhje me përmbushjen e objektivave që programin e studimit MP në SIG i Aplikuar ka për të realizuar. Personeli akademik me tematikat e përzgjedhura për mbrojtjen e gradës shkencore Doktor përmbush kërkesat për një program cilësor të ciklit të dytë MP në SIG i Aplikuar. Krahas dokumentacionit, gjatë takimit në institucion u informuam nga anëtarët e personelit akademik të DGJ qe angazhohen në program se ata vazhdojnë të kryejnë trainime të thelluara në fushën e GIS. Kjo dëshmon për përpjeket që ata bëjnë në rritjen e shkallës së profesionalizmi me qëllim për ti shërbyer më me cilësi zhvillimit të programit të studimi SIG i Aplikuar.</p> <p><i>Evidenca:17, 43, Vizita në institucion, takimi me personelin akademik</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të	Departamenti i Gjeografisë i cili është përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e programit të studimit MP në SIG i Aplikuar zhvillon procesin mësimor në mjediset e FHF, në godinën kryesore. Për realizimin e programit MP në SIG i Aplikuar Departamenti i Gjeografisë ka vënë në dispozicion të zhvillimit të leksioneve sallat 324, 326 dhe 311, ndërsa për zhvillimin e moduleve me karakter aplikativ dy Laboratorë GIS (sallat 328 dhe 329). Të dy laboratorët

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 57

<p>studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>janë me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> secili dhe akomodojnë 30 dhe 28 studentë.</p> <p>Në funksion të programit dhe moduleve përkatëse janë biblioteka e FHF dhe biblioteka e dedikuar për këtë program pranë DGJ. Në këtë të fundit ka tituj librash të specializuar nga autorë të huaj dhe shqiptarë në shërbim të procesit mësimor për studentët e programit.</p> <p>Nga vizita në instiucion grupi i GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në dokumentacion ishin të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh të cilat plotësojnë realizimin e objektivave mësimorë në funksion të 21 studentëve që ka ky program. Studentët e programit “SIG i Aplikuar” kanë patur në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen e realizimit si të orëve teorike ashtu edhe moduleve specifike të cilën e dëshmojnë edhe në takimin që GVJ pati me studentët e këtij programi. Nga studentët e theksua efikasiteti i realizimit të orëve aplikatike në laboratorin GIS, i cili u ka dhënë mundësinë e zbatimit dhe përshatjes më shpejt në pozicionet e punëve që ata kryejnë aktualisht. <i>Evidenca: 24, 43, 73, RVB, Takimi me studentë - Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në FHF, mjediset mësimore ku zhvillojnë procesin mësimor studentët e programit MP “SIG i Aplikuar” garantonin realizimin e procesit mësimor. Ato janë të paisur me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit videoprojektorë dhe monitorë. Laboratorët janë të paisur me kompjutera, priter/fotokopje/skaner, projektor. Institucioni ka një numër të mjaftueshëm laboratorësh.</p> <p><i>Evidenca: 24, 57, RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave</p>	<p>Laboratorët e dedikuar për programin e studimit MP në SIG i Aplikuar përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve. Ata kanë akses në internet pa limit dhe në çdo moment mund të lidhen me baza të dhënash hapsinore on-line apo faqe të ndryshme që mundësojnë qasje të ndryshme të nevojshëm për realizimin e detyrave individuale apo projekte.</p>

formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratori 329 ka 30 kompjutera dhe Laboratori 328 10 kompjutera. Në to janë instaluar programet kompjuterike ArcGIS 10.8 Desktop dhe ArcGIS Pro të liçensuar dhe programin "Open Source" QGIS. <i>Këto programe janë shumë profesionale dhe avangarde për realizimin e praktikës mësimore, detyrave në varësi të moduleve dhe projekteve lëndore. Evidenca: 24, RVB</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik, çdo ditë të javës nga ora 15.00-20.00. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me këto programe dhe pa raste të detyrave të realizuara nga studentët. <i>RVB; Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Kapacitetet e FHF dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. Disa nga këto institucione janë si, Bashkia Tiranë, kompani private, INSTAT. Mjediset mësimore si klasa, auditorë e laboratorë mundësojnë realizimin e procesit mësimor.  Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndihmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies/mësimnxënies në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore teorik dhe praktik mësimor. <i>RVB; Vizita në institucion</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në nivel universiteti, UT vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Universitare në Rektorat dhe bibliotekën pranë FHF. Biblioteka e FHF garanton të drejtën e çdo studenti për, aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjenteve të mjediseve të brendëshme dhe të jashtëme të saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i të gjithë hapsirës së bibliotekës me rrjetin Wireless dhe të aksesohen në biblioteka on-line.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka që është në shërbim të programit të studimit MP në SIG i Aplikuar e ka njësinë qendrore në katin e përë me sipërfaqe 143 m<sup>2</sup> ka 51, 576 tituj dhe 60 vende leximi dhe ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Kjo njësi është e paisur me revista shkencore, punime të konferencave, periodikë të fushës së GIS, Hartografi.</p> <p>Gjatë vizitës GJV u njoh konkretisht me fondin e titujve të librave në shërbim të programit të studimit. Bazuar në këtë vizitë.</p> <p><i>GJV rekomandon shtimin e titujve të librave në gjuhë të huaj të pesë viteve të fundit. Evidenca 24, RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>FHF krijon kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët e programit SIG i Aplikuar në bibliotekat on-line. Gjatë vizitës në institucion punonjësja e bibliotekës konfirmoi duke na stimuluar një rast konkret për akses në këto biblioteka. <i>RVB, Vizita në Insitucion; Takimi me punonjësën e bibliotekës</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka në FHF ku edhe zhvillohet program i studimit MP në SIG i Aplikuar ka një fond prej librash me karakter revista shkencore, punimet e konferencave, periodikë të fushave të ndryshme dhe 60 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin e bibliotekës digjitale të universitetit dhe të bibliotekave on-line ndërkombëtare. Të gjithë studentët e këtij programi janë anëtarë të bibliotekës. Menaxhimi i bibliotekës kryhet nëpërmjet platformës on-line Për shkak të pandemisë, FHF ka shfrytëzuar qasjen në biblioteka digjitale, duke u ofruar punonjësve dhe studentëve të tij falas gamën e gjerë të librave në bibliotekat elektronike. <i>Evidenca 24, RVB, Vizita në institucion takimi me punonjësën e bibliotekës</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>FHF ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vinë nga njësitë bazë. Përgjegjësit e programit të studimit përmes kërkesave të marra nga personeli akademik me titujt e propozuar i përcjellin ato bibliotekës së FHF. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e stafit akademik dhe realizimi i procedurës për pasurimin e fondit realizohet në mënyrë periodike. <i>RVB; Takimi me punonjësen e bibliotekës</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-16.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj. <i>Takimi me punonjësen e bibliotekës</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar <i>RVB</i> institucioni disponon dhe ka funksional systemin E-Student, i cili koordinon të gjitha veprimet e stafit akademik, ndihmes akademik dhe studenteve. Në këtë sistem hidhen dhe aksesohen dokumente baze, plani mësimor, data e provimeve, rezultatet e provimeve etj. Secili pedagog dhe student duke filluar nga shtatori 2022 do të kishte kredencialet aksesimi në E-student. <i>RVB</i></p> <p>Aktualisht depozitimin dhe administrimin e informacionit e kryente sekretaria mësimore e cila e ruante informacionin në gjendje fizike dhe elektronike.</p>

	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, në takim me sekretarin mësimore GVJ u informua që ky system ishte në shërbim e sipër dhe kredencialet e personelit akademik dhe studentëve ishin në pritje për tu bërë funksionale në fillim të viti të ri akademik.</i></p> <p>Ndërsa menaxhimi dhe administrimi i informacionit on-line ne faqen e internetit dhe platformës Teams kryhej nga punonjës së zyrës së IT në FHF. <i>Evidenca 7 RVB dhe Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit për administrimin e informacionit, dokumentacionit, aktivitetin e personelit akademik dhe partënerve të angazhuar në programin e studimit MP në SIG të Aplikuar e kryen zinxhir, student-koordinator i programit-laburant-sekretari mësimore. Sipas kësaj hierarkie studentët informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj ashtu edhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që menaxhohet dhe administrohet nga ky system është dhe veprimtaria e sekretarisë mësimore duke plotësuar bashkëpunimin e të tre komponentëve Student/sekretari mësimore/personel akademik. <i>Evidenca 7, 41</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>DGJ në FHF që prej periudhës së mësimi on-line përmes platformës Teams vazhdon të mundësoj aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Nëpërmjet kësaj platforme realizohet hedhja e programit mesimor, materialeve lëndore apo moduleve, njoftimet që kryejnë personeli akademik, vlerësimi i studentëve. Përdormi në nivel institucional i këtij sistemi mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konsatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit;</li> <li>2. Monitorimi i planit mësimor;</li> <li>3. Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor;</li> <li>4. Raportimi mbi ecurinë e plotësimit të afateve të përcaktuara në Manual;</li> </ol> <p>Format e mbështetjes për studentët ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngarkimin e detyrave të kursit;</li> </ol>

	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Ngarkimin e projekteve;</li> <li>3. Marrjen e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik;</li> <li>4. Marrjen e vlerësimeve;</li> </ol> <p>Personeli ndihmës akademik që nga rregullorja e këtij programi është emërtuar <b>Laborant</b> ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t'iu bërë të ditur:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Grafikon e provimeve;</li> <li>2. Notat e provimeve;</li> <li>3. Lajmërime apo informacione të dërguara nga pedagogët apo departamenti;</li> <li>4. Vërtetime të ndryshme;</li> </ol> <p>Të gjitha evidentimet nga dokumente shoqërues, GVJ i konfirmoi ato si në takimin me studentët ashtu edhe me personelin akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohen në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga hulumtimi i dokumentacionit, në FHF e vetmja platforma që funksionon është Microsoft Team. Ajo mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga strukturat e NJSBC-së dhe jo vetëm. Nëpërmjet kësaj platforme merren të dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e personelit akademik. Gjatë vizitës GVJ kërkoi dhe e verifikoi këtë në një prej llogarive të personeli akademik në platformën Teams. <i>Evidenca 8, 5, 41, RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit MP në SIG i Aplikuar GVJ konstatoi se aktualisht nuk ka një sistem institucional funksional që të mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ.</p> <p><i>Mbështetur në këtë gjetje GVJ do të sugjeronte krijimin e një portali të dedikuar për studentët të cilët do të mund të informoheshin në kohë reale për oraret e mësimit, programet, materialet lëndore, literaturën e rekomanduar etj.</i></p> <p>Me të dhënat reale të grumbulluara do të mund të hartohen raporte monitorimi rreth performancës së procesit mësimor si nga personeli akademik, ndihmës por edhe pjesmarrjes së studentëve në frekuentimin dhe zhvillimin e procesit</p>

	mësimor. <i>RVB. Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	GVJ hyri në faqen e internetit të UT <a href="https://unitir.edu.al">https://unitir.edu.al</a> dhe FHF <a href="http://fhf.edu.al">http://fhf.edu.al</a> dhe konstatoi që ajo mund të konfirmojmë informacionin e kërkuar lidhur me gjuhën e hedhjes së informacionit në internet. <i>RVB. Vizita në institucion</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit. Ai përgatitet nga administratori dhe i dërgohet për njohje Bordit të Administrimit të UT. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit MP në SIG I Aplikuar dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. <i>Evidenca 33, 45; RVB</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesit në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit	Struktura e planit financiar është bërë duke klasifikuar të ardhurat sipas burimeve të siguruara. RVB Mbështetur në Planin e financimit të UT për vitin 2020-2021 burimet e financimit janë: A. Transferta të pakushtëzuara (Granti për mësimdhënien nga buxheti i shtetit); B. Të ardhurat e kushtëzuara; C. Sponsorizmie; D. Fondi i bursave të studentëve; E. Fonfe të trashëguara nga viti paraardhës 2020; Ndërsa, në mënyrë të specifikuar për programin e studimit burimet e janë:



<p>zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tarifa e regjistrimit 2000 lekë;</li> <li>2. Tarifa e shkollimit për vitin e parë dhe të dytë 60,000 lekë/vit;</li> <li>3. Pagat e personelit akademik efektiv dhe me kontrat; <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Pagat mujore nga buxheti i shtetit;</li> <li>b. Pagesat e orëve suplementare, të cilat mbuloohen nga FHF, nga gjenerimi i të ardhurave; <i>Evidenca: 33, 56</i></li> </ol> </li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentet shoqëruese, institucioni kryen auditim të brendshëm një herë në tre vite, sipas një plani të hartuar më parë nga drejtoria e Auditimit të Brendshëm në UT dhe të miratuar nga Bordi i Administrimit të UT. Në përfundim të procesit të auditimit DAB i dërgon njësisë kryesore një projekt raport me gjetjet dhe i kërkon drejtuesve të njësisë kryesore të shprehen brenda 10 ditëve për vërejtjet mbi gjetjet dhe rekomandimet e lëna.</p> <p>Raporti i vitit 2022 ka patur për objekt në aspektin financiar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përlllogaritjen e pagave; <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Sistemin e menaxhimit buxhetor dhe kryerja e veprimeve me thesarin;</li> </ol> </li> </ol> <p>Në raport ka pasqyra të detajuara për burimet e të ardhurave nga tarifatat e shkollimit e kontribute të tjera. Për vitin 2019 paraqiten të ardhurat e siguruar nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>b. Tarfifa regjistrimi;</li> <li>c. Tarifa shkollimi;</li> <li>d. Tarifa administrative;</li> <li>e. Të ardhurat nga ambiente me qera;</li> <li>f. Të ardhura sekondare;</li> <li>g. Shitje shtypshkrime;</li> <li>h. Sponsorizime dhe sponsorizime të jashtme;</li> </ol> <p>Krahas pasqyrave financiare për të ardhurat ka edhe për shpenzimet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Shpenzime për udhëtime jashtë shteti;</li> <li>b. Shpenzime nga të ardhurat e fakultetit FHF;</li> <li>c. Shpenzime nga granti për fakultetin FHF;</li> <li>d. Shpenzime për konferenca shkencore FHF;</li> <li>i. Shpenzime publiciteti;</li> </ol> <p>GVJ mbështetur në dokumentacionin mbështetës konstaton se raport auditimi është i detajuar në pasqyra</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 65

	financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e burimeve financiare. <i>Evidenca 44, RVB</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Bazuar në RVB dhe dokumentet shoqëruese institucioni dokumenton raportet financiare të cilat përmbajnë transparencë përsa i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në nivel institucioni raportet janë periodike, të përvitshme. <i>Evidenca 56, 45, 5, RVB</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<p>DGJ që është përgjegjës për programin e studimit MP në SIG I Aplikuar i siguron burimet e financimit për këtë program nga:</p> <p>A. Nga gjenerimi i të ardhurave nga hapja e programit, (tarifa për dhe gjatë shkollimit);</p> <p>B. Nga buxheti i shtetit;</p> <p>C. Projekti GEOWEB mbi të cilin është krijuar ky program studimi zhvillohet në kuadër të programit ERASMUS +, të financuar nga Komuniteti Europian;</p> <p>Krahas dokumentacionit të gjerë, GVJ bazuar edhe në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndëruar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucion. <i>Evidenca 56, 33, 5, Takimi në Institucion</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 66

**Standardi V.1**

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Ky program studimi është ndërtuar dhe bazuar në rregulloren e vet përkatëse të programit të studimit, në rregulloren e universitetit, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në rregulloren e këtij program studimi përcaktohen qartë të gjitha organet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre për mbarëvajtjen e plotë të këtij program studimi. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumentave të tjera të FHF dhe DGJ dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t'u bere me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjate të gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni. <i>(neni 2, efekti juridik).</i></p> <p>Në kreun VIII, <i>nenin 42</i> të rregullores së programit të studimit MP në SIG i Aplikuar, thuhet se një ndër shtyllat e aktiviteteve kryesore janë pikërisht studentët. Shtylla e studentit në qendër përfshin organizimin dhe bashkëpunimin e njesive të angazhuara në proceset në mbështetje të studenteve që nga njohja e tyre me DGJ deri tek pranimi, regjistrimi, angazhimi në jetën studentore dhe komunitare, mbështetja në përparimin profesional, dhe në karrierë, etj.</p> <p>Përgjatë vizitës në institucion, një ndër pikat e axhendës të organizuar nga ASCAL, ishte edhe takimi me strukturat që janë në kontakt me studentët dhe që i informojnë ata që nga fillimi i programit deri në përmbylljen e tij.</p> <p>Institucioni ka një mirëorganizim dhe vëmendje përmes strukturave të ngritura për studentët që nga hyrja e deri në dalje. Konkretisht disa prej këtyre strukturave janë: Koordinatorin e programit, Zyra e Alumnit dhe Karrierës dhe vetë organizimin studentor.</p> <p>Ndërkohe që një ndër parimet e funksionimit të UT e reflektuar edhe në rregulloren e institucionit, të programit dhe dok e tjera shoqërues strategjik, lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë të programit të studimit. <i>Evidenca 1, 2, 4, 5.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së</p>	<p>Referuar RVB por të konstatuara edhe në dokumentacionin shoqërues kriteret e pranimit të studentëve në programin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 67

<p>studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>studimit MP në SIG i Aplikuar propozohen nga koordinatori i programit të studimit dhe miratohen nga Komiteti Shkencor i cili njëherazi ndjek edhe zbatimin e tyre sipas nenit 13, pika f.</p> <p>Kriteret iu bëhen me dije studentëve të ciklit të parë Bsc në Gjeografi nëpërmjet takimeve informuese me personelin akademik të Departamentit të Gjeografisë. Takimet zhvillohen në periudhën maj-qershor me studentët e vitit të tretë që përfundojnë ciklin e parë në këtë njësi. Krahas kësaj forme të drejtë përdrejtë informimi kriteret bëhen të ditura edhe nëpërmjet faqeve zyrtare të FHF-së. Ato janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku i interesuar.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me studentët e këtij programi u konfirmua pjesmarrja e tyre në takimet me personelin akademik për sqarime rreth kriterëve të përzgjedhjes. Duke mbajtur parasysh që pjesa dominante e studentëve që ndjekin këtë program studimi vijnë nga cikli i parë i studimeve Bsc në Gjeografi. <i>Evidenca 5, RVB</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Çdo vit akademik, për të ndjekur MP-SIG i Aplikuar pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Lugina e Preshevës, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia dhe Mali i Zi, si dhe nga vende të tjera nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe. Programi për studime për MP-SIG i Aplikuar synon të jetë një kurs i hapur për të gjithë studentët që kanë një diplomë të ciklit të parë, të dytë ose të integruar në gjeografi ose ECTS të mjaftueshme në lëndët gjeografike të fituara në degë të tjera të universiteteve të vendit ose të huaja. GVJ e konfirmon këtë <i>në kreun VII "Politikat e pranimit"</i> të rregullores së programit të studimit MP SIG I Aplikuar. <i>Evidenca 5, RVB</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Hapja e fushatës për pranime në MP-SIG i Aplikuar bëhet nga dt. 1-30 maj të çdo viti. Shpërndarja e këtij informacioni bëhet përmes mënyrave dhe rrugëve të komunikimit që nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• publikimet në rrjetet sociale;</li> <li>• por edhe ëeb zyrtar te FHF, DGJ;</li> <li>• ne ambientet fizike te institucionit;</li> </ul> <p><i>Evidenca 5; RVB</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyruar GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Keshtu studentet informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera heret në kohe, sikurse pranohen edhe transferime të studenteve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedure është e rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet në Satutin e UT, Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, Rregulloren e programit të studimit MP SIG i Aplikuar. Gjithashtu, sekretaria mësimore në bashkëpunim me departamentin e gjeografisë dhe koordinatoren e programit të studimit informojnë dhe lehtësojnë studentin me vlerësime paraprake për transferim studimesh apo njohje të tyre.</p> <p><i>Evidenca 2, 12, 5, RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Nëpërjet rregullore të programit të studimit;</li> <li>B. Nëpërmjet praktikës së informimit të studentëve të vitit të tretë të programit Bsc në Gjeografi;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Nëpërjet rregullore të programit të studimit;</li> <li>B. Nëpërmjet praktikës së informimit të studentëve të vitit të tretë të programit Bsc në Gjeografi;</li> </ul>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>C. Njëpërmjet syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde;</p> <p>D. Njëpërmjet personelit akademik në fillim të çdo semestri;</p> <p>E. Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët;</p> <p>Gjithashtu, në lidhje me procedurat e diplomimit eksiston një informacion i shprehur përmes rregullores së programit të studimit ku në <i>Kreun V</i>, “Vlerësimi i Studentit” jepen me detaje:</p> <p>A. Procedurat dhe kriteret e vlerësimit;</p> <p>B. E drejta për të hyrë në Provim;</p> <p>C. Zhvillimi i provimeve;</p> <p>D. Komunikimi i Vlerësimeve;</p> <p>Në <i>Kreun 6</i> “Diplomimi” përcaktohen qartë</p> <p>A. Procedura e diplomimit;</p> <p>B. Marrja e Diplomës;</p> <p>GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me procedurat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me student në ditët e vizistës në institucion <i>RVB, Evidenca 5, Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Në mënyrë periodike përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni me praninë e koordinatorit të programit të studimit, personelit akademik të Departamentit të Gjeografisë organizon takime të hapura për tun jour me programin e studimit nga palët e interesuara për të. Sipas rregullores së brendshme të programit takimi realizohet në muajin maj.</p> <p><i>RVB, Evidenca 5, Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Sipas statutit të UT janë ngritur disa njësi që janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e cilësisë dhe kontrollit të performancës si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Senati Akademik;</li> <li>• Bordi i Administrimit;</li> <li>• Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë KPSSC;</li> <li>• Rektori i UT;</li> <li>• Administratori UT;</li> <li>• Njësitë e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë NJSBC në nivel universiteti;</li> <li>• Njësitë e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë NJSBC në njësitë kryesore;</li> <li>• Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët;</li> </ul> <p>Mundësitë e informimit fizik merren në institucion pranë disa zyrave apo njesive që ofrojnë informacione për çdo program të detajuar që interesohet studenti. Në momentin që një student është i duazuar midis dy apo disa programeve të studimit, atëherë drejtuesi i departamentit dhe/ose kordinatori i programit i ofron informacione me të detajuara për programet e interesuara me qëllim që studenti të marrë informacione me të detajuara dhe të hollësishme të nevojshme për vendimmarrje.</p> <p>Përveç kësaj departamenti përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi ka angazhuar edhe pedagoge me kohe të pjeshme duke u munduar të profilizojë ato me lëndet që japin mesim. Por së pari, është departamenti si njesia kryesore përgjegjëse e ofrimit të këtij program studimi e cila është përgjegjëse për mbarëvajtjen e këtij programi, e kontrollon dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe reflekton përmes raporteve dhe analizave vjetore/periodike. Institucioni ka vendosur një procedurë e cila përfshin së pari departamentin që është përgjegjës për këtë program studimi, stafin që angazhohet në mesimdhënie me kohe të plote e të pjeshme përmes raportimeve dhe informacioneve të dhëna nga to, sikurse dhe përmes njesive të tjera. Kështu, ngritja e strukturës <b>Kujdestari i Studentëve</b> (neni 127 I Statutit</p>

	<p>të UT) është një qasje mbështetëse dhe pozitive për studentin dhe për ta përfshirë jo vetëm në qasjet sociale të institucionit por edhe ato edukuese, mesimdhënëse të përditshme me të cilat perballen studentet.</p> <p>Përgjegjësitë e MP SIG i Aplikuar të sanksionuara në nënin 44 të rregullores së brendshme të programit u jep studentëve mundësinë e njohjes me strategjinë e zhvillimit të programit, planet dhe programin mësimor, rregullat e vlerësimit, rregullat e praktikës, rregullat e mbrojtjes së tezës, u asiston studentëve të marrin pjesë në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e planit mësimor. <i>Evidenca 2, 5.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takim me studentët edhe përfaqësuesit e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me format e informimit që ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Veprimtari informuese që organizon vetë departamenti;</li> <li>2. Informim nga pedagogët;</li> <li>3. Informim nga strukturat administrative në Rektorat;</li> <li>4. Informacioni i marrë në faqen zyrtare të internetit;</li> <li>5. Informacioni vihet në dispozicion të një publiku më të gjerë me anë të njoftimeve të zyrave të informimit apo Karrierës dhe Alumni në website-in zyrtar të UT, FHF për studentët e departamentit të gjeografisë;</li> </ol> <p>Të gjitha format e renditura u japin mundësi të barabartë të gjithë studentëve për të qenë të informuar. Gjithashtu mundësi të barabartë iu ofrohet edhe kandidatëve për student në këtë universitet nëpërmjet shpalljes së detyrueshme të listës së studentëve fitues në programin e studimit në stendën e njoftimeve të universitetit edhe në faqen zyrtare të FHF dhe DGJ.</p> <p><i>Evidenca 8, 59</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

**Standardi V.4**



**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë\*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ statistika që tregojnë të dhëna për numrin e studentëve aktuale për tri vitet e fundit akademike si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Per vitin akademik 2019 2020: 25 studente</li> <li>• Per vitin akademik 2020-2021: 25 studente</li> <li>• Per vitin akademik 2021 2022: 21 studente</li> </ul> <p>Nderkohe 2 studentë janë angazhuar në projekte kërkimore në rang departamenti nga lektore të angazhuar në kët program studimi. Për periudhën 2019-2022 janë diplomuar 25 studentë, janë punësuar në përputhje me diplomën 9 studentë ndërsa jo në përputhje me diplomën nuk ka të punësuar.</p> <p><i>Evidenca 68</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ-së, iu vunë në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program. Nga konstaimi rezultoi që nuk ka student të transferuar nga ky program studimi. Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin e studimit Master Profesional në SIG I Aplikuar.</p> <p><i>Vizita në institucion-Takimi në sekretarinë mësimore; RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në shqyrtimin e dokumentacionit është konstatuar se institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomim. Në mënyrë të veçantë të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, kalueshmëria dhe nota mesatre e të diplomuarëve janë përpiluar nga Koordinatori i programit. <i>Evidenca 70</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe</p>	<p>Zyra përgjegjëse për disponibilitetin e të dhënave është sekretaria mësimore e cila mban të dhënat e studenteve në regjistrin e të dhënave akademike, të cilat gjenden njëkohësisht edhe në form elektronike. Ndërkohe platforma E-Student përbën një format elektronik të të dhënave të</p>

lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	përdorur jo vetëm nga studentët por edhe sekretaria që në cdo kohë ka akses për të hedhur notat dhe rezultatet e provimeve, datat përkatëse të zvillimit të provimeve dhe kalendarin e provimeve, etj. Ndërkohe që ky portal shërben si burim record informimi për studentët për vleresimet e tyre akademike. <i>RVB; Evidenca 7, Vizita në institucion-Takimi me sekretarinë mësimore</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni dëshmon se ka ndërtuar tabela të përfshira në aneksin e tabelave me informacione në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studenteve, ku reflektohet jo vetem nr i studenteve te regjistruar per cdo vit akademik qe nga 2019-2020 si vit i pare i lancimit të këtij programi, por edhe mesataret përkatëse të studenteve, numrin e transferimeve brenda këtij program studimi, numrin e të diplomuarve si dhe ato të diplomuar sipas ose jo profilit te diplomes.  Ndërkohe që edhe vetë departamenti e përfshin këtë çështje të raporteve analitike të studentëve në raportimet vjetore të tyre, ndersa zyra e karieres i mundeson dhe ofron pergjate te gjithë kohes studenteve mundesi për këshillim karriere dhe shkrimin e CV. <i>RVB; Evidenca 70, 68, 59</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Dokumentacionet shoqëruese tregojnë se institucioni i përfshin studentet në forma të ndryshme në këtë program studimi. Përveç pasjes së nje Kujdestari i Studentëve posaçërisht për ta, u mundesohet midis te tjerave edhe një jete sociale në komunitet e më gjerë.  <i>RVB; Evidenca 2, 4, 6; Takimi me Studentët-Vizita në institucion;</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me grupin e studentëve u qartësua se për problematika, vendimmarrje apo rradhë të ndjekjes së procedurave përkatëse është:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Studentët fillimisht i përcjellin senatorëve të tyre shqetësimin apo informacionin;</li> <li>Senatorët ia përcjellin koordinatorit të programit;</li> <li>Koordinatori/program ia përcjell përgjegjësit të departamentit;</li> <li>Përgj/Dep ia përcjell Kujdestarit të studenteve;</li> </ol> <p>Studentet ftohen të japin opinionet e tyre, dhe nga njëjësia e sigurimit të cilësisë 2 herë në vit, e cila grumbullon perceptimet e studentëve për secilen lëndë dhe secilin personel akademik. Studentët janë të përfaqësuar edhe me një anëtar në hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të këtij program studimi. <i>RVB; Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e UT, FHF, DGJ, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorësh në përfundim të çdo semestri. Nga shqyrtimi i disa modeleve pyetësorësh GVJ konstaton se studentëve Ju kërkohet të vlerësojnë sipas rubrikave:</p> <p><b>Lëndët e zhvilluara:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Lëndë të përshtatshme për programin e studimit;</li> <li>Lëndë të vështira;</li> <li>Lëndë të papërshtatshme për programin e studimit;</li> <li>Lëndë që ju aftësojnë praktikisht;</li> <li>Lëndë që përmbajnë informacion bashkëkohor;</li> </ol> <p><b>Realizimin e orëve:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Realizimi i leksioneve;</li> <li>Seminareve;</li> <li>Diskutimeve;</li> </ol> <p><b>Vlerësimin e performancës së personelit akademik:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Përdorimin e metodave;</li> <li>Motivimin e studentëve;</li> <li>Vlerësimin e studentëve;</li> <li>Respektin ndaj studentëve;</li> </ol> <p><b>Vlerësimin e materialeve mësimore:</b></p>

	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Materialet mësimore janë të përshtatëshme për lëndën;</li> <li>2. Biblioteka është e pasur;</li> <li>3. Interneti përdoret në funksion të mësimi;</li> <li>4. Teknologjia mësimore përdoret në funksion të mësimi;</li> </ol> <p>Pyetësi studentor hartohet në bashkëpunim midis sektorit të kurikulave, sigurimit të cilësisë dhe NJSBC-së. Pyetësi siguron anonimin e studentit. GVJ konstatoi se institucioni jo vetëm që përfshin studentët në procesin e vlerësimit por vjel mendimin e tyre në çdo aspekt të procesit mësimor dhe infrastrukturës mësimore. Informacioni i grumbulluar është i bollshëm për të hartuar raporte të cilat analizojnë rezultatet e këtyre instrumentave në nivel të strukturave drejtuese.</p> <p><i>Evidenca 6, 26; Takimi me Studentët-Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga shqytimi i planit mësimor të Programit MP “SIG i Aplikuar” është vërejtur një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore në të gjashtë semestrat me nga 20 ECTS secili. Struktura e planit mësimor tregon që veprimtaritë leksion, seminare, praktika, provimi janë në vijueshmëri, merren në mënyrë të balancuar nga njëri semester në tjetrin dhe nga njëri vit në tjetrin. Praktikat zhvillohen në formën e praktikave profesionale stazh, në përfundim të vitit të dytë dhe ka 12 kredite që konvertohen në 300 orë në total. Në varësi të peshës së njohurive që ka secila lëndë është bërë edhe shpërndarja e ngarkesës në kredite, që varion nga 4-6 kredite për lëndët me zgjedhje dhe 7,8,9,10 të lëndëve të detyrueshme. Për tu theksuar është që orët në dispozicion të ushtrimeve dhe laboratorit zënë vend të rëndësishëm në totalin e orëve mësimore të lëndëve të këtij program. Kjo e bënë atë program studimi me karakter aplikativ që i shërben paisjes më kompetenca profesionale të studentëve, të gatëshëm për tregun e punës.</p> <p>GVJ konfirmoi edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion që ngarkesa mësimore është e balancuar dhe nuk u krijote vështirësi në marrjen e njohurive në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme. Orët e ushtrimeve në laborator ata i konsiderojnë me shumë efikasitet, gjë të cilin e kanë ndjerë edhe në punët që ata kryejnë. <i>Evidenca 65, Vizita në institucion-Takimi me studentët</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e UT, përcaktohet procedura në rast ankese nga student në nenin 51 dhe 50 të rubrikës Ankimi. Sipas këtij neni studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Për këtë duhet ti drejtohet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimeve. Ai bënë verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhejn i drejtohet dekanit. Ky i fundit brenda 48 orëve ngre një komision ad hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit Me miratimin e dekanit komisioni bënë vlerësimin përfundimtar.</p> <p><i>GVIJ sygjeron që rubrika ankimim dhe nenet përkatëse të saj të përfshihen edhe në rregulloren e programit të studimit MP "SIG I Aplikur" duke qenë se janë në mungesë.</i></p> <p><i>Evidenca 4; Takimi me studentët; RVB</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b></p> <p><b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të</p>	<p>Njësia e posaçme që kryen informimin është zyra e këshillimit të karrierës pranë FHF, sekretaria mësimore, të cilët ofrojnë shërbim ditorë të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. Krahas tyre edhe koordinatori për studentët ofron shërbime për të gjitha kërkesat, paqartësitë, procesin e këshillimit, informimit dhe ndjekjen e studentëve.</p> <p>Rolin e sekretarisë online e luan e-maili zyrtar i dërguar nga sekretaria mësimore. Ai bënë të mundur përmbushjen e të gjitha detyrimeve të procesit mësimor të parashikuara në rregulloren e UT.</p>

<p>studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe zyrën e informimit të FHF u vu re nga GVJ që informimi i studentëve kryhej në përputhje me aktet rregullatore të UT. Në shtator pritej të funksiononte me kapacitet të plotë sistemi E-Student. <i>GVJ rekomandon që të kontrollohet me përparësi eficaenca e këtij sistemi E-student në të ardhmen. Evidenca 20, Minutat e takimit-Vizita në sekretarinë mësimore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të Ut që prej vitit 2015. <i>Evidenca 20</i></p> <p>Format e shërbimit që ZKK ofron për studentët janë informim dhe orientim profesioanl siç është informimi për praktika profesionale. Ajo në bashkëpunim me koordinatorin e programit të studimit MP në “SIG i Aplikuar” informon studentët e këtij programi listën e marrëveshjeve për realizimin e praktikës mësimore dhe pjesmarrjen e tyre në panaiet e punës. <i>RVB; Evidenca 22, 67.</i></p> <p>Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit MP “SIG i Aplikuar” mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucionet Bashkia e Tiranës, Instituti i Shëndetit Publik, INSTAT, etj. Njëherazi prej studentëve morrën vlerësime rreth cilësisë së shërbimit prej kësaj njësie. <i>Evidenca 20, 22, 67, RVB. Takimet në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Raportet e gjurmimit të studentëve tregojnë për një procedurë të rregullt dhe sistematike të mbajtjes së kontakteve me studentët Alumni. Raportet gjithashtu tregojnë se procesi i gjurmimit të studentëve kryhet si nëpërmjet email-ve personale, telefonatave dhe faqes se ZKK. <i>Evidenca 34, 35, 19.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është, Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Njësi e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), që vepron për çdo njësi kryesore. Standardet për sigurimin e cilësisë në UT janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. <i>Evidenca 2, 4, 37, 3, 38.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	FHF ka njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) e cila ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. NJSBC ka akses në të gjitha të dhënat e FHF. Gjithashtu zyra e Standardeve dhe Cilësisë realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në FHF. Institucioni angazhon dhe ekspertë të jashtëm pranë NJSBC-së.  <i>RVB: Evidenca 38, 3.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve	UT, FHF përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Instrumenti që përdor UT, FHF për sigurimin e cilësisë është "Manuali i Cilësisë" i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. <i>RVB.</i> NJSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë

analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. Në takimin me përfaqësues të NJSBC në FHF dhe takimin me GVB, konkretisht, studentin që ishte pjesë e grupit të punës, u theksua realizimi dhe pjesëmarrja e aktotëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë. *RVB*

**Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Institucioni ka politika dhe procedura të qarta për të siguruar cilësinë. Struktura përgjegjëse NJSBC, programon punën në bazë të strategjisë/manualit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, dhe planit të veprimit të përvitshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, procedurat periodike që përdor për të siguruar cilësinë janë:

A. Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të brendshëm;

B. Realizimi i procesit të matjes së perceptimit të studentëve nga nga NJBSC-në bashkëpunim me koordinatoren e programit për cilësinë e mësimdhënies në fund të çdo semestri;

C. Realizimi i pyetësorëve me studentët nga pedagogët e lëndes, në përfundim të çdo semestri me qëllim vlerësimin e performancës së personelit akademik nga ana e studentëve;

D. Hartimi dhe realizimi i analizës së punës mësimore-kërkimore në nivel departamenti dhe fakulteti;

Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë.

GVJ gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konfirmon realizimin e të gjitha proceduarve periodike për vlerësimin e cilësisë. *Evidenca 3, 34, 36.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 80



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit është Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, KPSSC. Në nivel njësie bazë, është Departamenti që ka programin e studimit, i cili së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. <i>RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>FHF përmes NJSBC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Fakulteti. Përmbajtja e këtyre raporte trajtohet në disa nivele brenda institucionit.</p> <p>NJSBC nëpërmjet kontolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, zbulon problematika të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës dhe i referon ato departamentit për rishqyrtim. Në kuadër të objektivave të saj, NJSBC siguron bazën e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. Në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, NJSBC mbikëqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve. <i>RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FHF dhe struktura përgjegjëse NJSBC përmes zbatimit të planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Ajo merr në shqyrtim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Kontrollin e vazhdueshëm të realizimit të ngarkesës lëndore dhe pasqyrimin të saj në regjistrin e pedagogut;</li> <li>B. Monitorojnë përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të dosjeve mësimore të personelit akademik, e cila është objekt kontrolli nga NJSBC.</li> </ul> <p>Kontrollon zbatueshmërinë e formateve të miratuara të syllabuseve lëndore në përputhje me Udhëzimin Nr. 41, dt. 24. 01. 2018 të MASR. <i>RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet e realizuara nga NJSBC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në nivel Rektorati, Dekanati dhe Njësie Bazë.</p> <p><i>Evidenca 34, RVB</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Bazuar në RVB-në, monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga NJSBC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve.</p> <p>Në raportet e hartuara janë evidentuar dhe paraqiten këto mangësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cilësia e materialeve mësimore (literaturës);</li> <li>2. Cilësia e performancës së personelit akademik;</li> <li>3. Komunikimi pedagog-student;</li> <li>4. Konceptimi i transparencës në vlerësim;</li> <li>5. Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit;</li> <li>6. Raporti teori/ praktikë në kurrikula, etj;</li> </ol> <p>Mangësit ju bëhen me dije personelit akademik të departamentit të HGJ dhe në mbledhjet e organizuara në këtë njësi ato bëhen objekt i analizës vjetore. Nga takimi që GVJ pati me personelin akademik të njësisë konfirmoi jo vetëm realizimin e analizës rreth mangësive por edhe u njoh më konkretisht me disa prej masave që personeli akademik kishte marrë për përmirësimin e tyre siç ishte, shmangja e njohurive paralele në lëndë të përafërta, përmirësimin e formave të vlerësimit, ose shtimin e numrit të lëndëve me zgjedhje/ me karakter më praktik. <i>Evidenca 34, 3.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UT, FHF. NJSBC-ja realizon vlerësim periodik në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. Departamenti realizon analizë të</p>

<p>përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>përgjithsme për programin e studimit MP “SIG i Aplikuar”. <i>Kjo strukturë nuk harton relacione specifike në bazë programi. Evidenca 34; RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të RVB-së dhe nga nga takimi më anëtarë të NJSBC konstatuam përdorimin e disa instrumentave për realizimin e procesit të vlerësimit si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëpërmjet anketimit realizohet vlerësimi për çdo lëndë të çdo pedagogu nga studentët;</li> <li>2. Përdorimi i fokus grupeve;</li> <li>3. Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit;</li> </ol> <p>GVJ konsaton se përdorimi i metodave dhe instrumenteve për vlerësim janë në përputhje me natyrën e programit të studimit MP në “SIG i Aplikuar” në FHF, UT. <i>RVB, Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga takimin me përgjegjësin e departamentit dhe shqyrtimi i dokumentacionit na rezulton se institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit. Për kategorinë lektor/asistent lektor realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Format i vlerësimit të performancës akademike nga studentët bëhet në përputhje me manualin e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 3; Vizita në Institucion; Takimi me PD, Stafin Akademik; Takimi me GVB; RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Institucioni kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes anketimeve; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. NJSBC është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit.</p> <p>Krahas detyrës që kryen NJSBC departamenti i HGJ përdor instrumente të tërthorta vlerësimi lidhur me cilësinë e programit si:</p>

<p>administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>A. Komete formale dhe joformale të studentëve;  B. Takime me ish-studentë;  C. Pyetësorë;  D. Takime me Drejtorinë Rajonale Arsimore, Drejtues shkollash;  E. Sondazhe nga personeli akademik për lëndët që ata lektorojnë;</p> <p>GVJ nga takimi me personelin akademik të njësisë që zhvillon programin, konfirmi realizimin e këtyre formave të tërthorta vlerësimi. Ata i konsideronin ato si një barometër të punës së tyre të përditëshme nga njëra anë por edhe si piketa për të vendosur prioritet në të ardhmen. <i>Evidenca 3, RVB</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas Statutit dhe Rregullores së UT ka parashikuar përfshirjen e aktorëve të ndryshëm:</p> <p>a. Personel Akademik të brendshëm;  b. Personel Ndhmës Akademik;  c. Personel Administrativ;  d. Studentë;</p> <p>UT, FHF realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus +. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e funksionit e sigurimit të cilësisë së brendshëm.</p> <p><i>Evidenca 2, 4, RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor si Statut, Rregullore e UT,</p>

<p>për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullore e MP SIG i Aplikuar, mbi të cilin funksionon UT dhe njësitë përbërse të tij.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin mbështetës GVJ i rezulton se ekzistojnë urdhëra të rektorit dhe vendime të drejtuesit të njësisë bazë për detyra konkrete që njësitë dhe individët angazhohen në organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe koordinimin e saj sektorin e projekteve, kërkimit shkencor dhe të botimeve në UT, FHF.</p> <p>GVJ konstaon vetem vendime në nivel rektorati dhe dekanati.</p> <p><i>Evidenca 4, 49, RVB</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Gjatë procesit të realizimit të pyetësorit ajo përfshin në sondazhet për vlerësim të gjithë personelin akademik, studentët e Departamentit të Gjeografisë të ciklit të parë dhe të dytë dhe personelin ndihmës akademik. Gjithashtu, siguri i cilësisë së programit bëhet objekt analize çdo fund viti akademik nga vetë njëzia bazë që e ofron programin Mp “SIG i Aplikuar”, nga departamenti.</p> <p><i>Evidenca 34; RVB</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>UT, FHF ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj). Bazuar në RVB anëtarët e NJSBC për njësinë kryesore nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, etj.</p> <p><i>RVB; Evidenca 38</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Nga RVB nuk është shumë e qartë nëse ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Gjithashtu GVJ konstaton mungesë të dokumentacionit mbështetës lidhur me rolin që ekspertiza e jashtme duhet të japë në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit. RVB</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Dekani i FHF. Rregullorja e NJSBCS është dokumenti në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit të veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Këto dokumenta sikundër pranohet në RVB dhe "...raportet e NJSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë". <i>Evidenca 37; RVB</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elemente që lidhen me këtë njësi. RVB Në departament trajtohet me stafet akademike ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Në RVB nuk jepet e qartë nëse raportet e NJSBC-së janë të aksesueshme për të gjithë stafin akademik apo për studentët.  <i>GVJ sygjeron që një përmbledhje e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të jenë publike dhe të aksesueshme si për stafin akademik ashtu edhe për studentët e më gjerë. RVB</i>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon në vijueshmërie procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor. <i>RVB</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të FHF reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. <i>RVB</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për	Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesin në dokumentat ku bazohet kjo

informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. <i>RVB</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar"**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i Studimeve Master Profesional "SIG i Aplikuar" hapet në plotësim të kërkesave që ka tregu i punës në vendin tonë për modelimin dhe përdorimin e të dhënave gjeohapsinore. Si program i parë në këtë fushë, ai ka ngjallur interes si tek kontigjentet hyrëse ashtu edhe tek punëdhënësit;
2. Ai është hapur mbështetur në konsultimin e personelit akademik të Departamentit të Gjeografisë me kolegë nga vende të BE-së, në kuadrin e projektit ERASMUS + (GEOWEB) me objektiv modernizimin e arsimit të lartë, si i tillë ka edhe indentitet kombëtar edhe identitet evropian;
3. Plani mësimor dhe syllabuset e Programit të Studimeve Master Profesional "SIG i Aplikuar" janë kompozuar duke marrë në konsideratë përvojën e programeve të singjashme në vendet e BE-së. Ky fakt përbën një avantazh të dukshëm për kooperim reciprok, mobilitet si dhe për indeksim të nivelit të tij në nivelin e programeve të singjashëm;
4. Baza laboratorike e këtij programi është bashkëkohore dhe do mbetet e tillë për shkak të bashkëpunimit me programet e singjashëm në vendet partnere të BE-së;
5. Shkalla e lartë e punësimit të të diplomuarve nga ky program studimi ndikon në forcimin e imazhit të tij si një program që ia vlen t'a frekuentosh;
6. Personeli akademik i këtij programi ka investuar dhe investon njohuritë dhe përkushtimin e tij duke u krijuar studentëve një mjedis, ku ata ndjehen jo vetëm të mirëpritur por mbi të gjitha të mirëtrajtuar në përpjekjet për t'u bërë profesionistë të vlefshëm;

#### **b. Pikat e dobëta:**

1. Mosmbulimi në masën 70% i ngarkesës mësimore të programit të studimit nga staf akademik efektiv, krijon pasiguri në planifikimin e ngarkesës vjetore dhe mund të çojë në zgjidhje të detyrueshme duke angazhuar staf akademik me kontratë, pa kompetencën e duhur ose duke rritur ngarkesën e stafit efektiv, jashtë normave që përcaktojnë standardet: (Standardet II-4, II-5);
2. Mungesa e aksesimit nga ana e studentëve në bibliotekën online i kufizon ata në shfrytëzimin më eficient të literaturës (Standardi III-3);
3. Mungesa e sistemit të komunikimit të brendshëm elektronik krijon vështirësi në evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave si në procesin mësimor ashtu edhe në atë administrative (Standardi III-3);

#### **Rekomandime**

1. Institucioni të të rekrutojë staf akademik efektiv, për të mbuluar ngarkesën e orëve në auditor mbi masën 70%, në përputhshmëri me aktet nënligjore në fuqi;
2. Të reduktohet sasia e orëve suplementare për stafin akademik efektiv, së paku deri në 200 orë, që është vlera e përcaktuar nga Udhëzimi 29, datë 10.09.2018 i MASR;
3. Të planifikohen e të organizohen më tepër konsulta me tregun e punës për të marrë e konsideruar më tepër feedback-un e tyre;
4. Të shtohen titujt e literaturës specifike për këtë PS, kryesisht në gjuhë të huaj pasi mungonin në fondet aktuale të bibliotekës dhe të mundësohet aksesimi nga ana e studentëve në e-library;
5. Të vihet sa më shpejt në funksionim sistemi e-student për aksesim në dokumentacioni elektronik dhe hapsirë vetiake të dedikuar;
6. Duke qenë në fillimet e tij, Programi i Studimeve Master Profesional "SIG i Aplikuar" ka nevojë t'i jepet mbështetje e vazhdueshme institucionale për të patur qëndrueshmëri në personel dhe përditësim në infrastrukturë;

### **Evaluation results of the second cycle study program, Professional Master in "Applied Geographical Information System"**

#### **a. Strengths and Affirmations:**

1. The Professional Master Studies Program "Applied SIG" is opened in full compliance with the requirements of the labor market in our country for the modeling and use of geospatial data. As the first program in this field, it has aroused the interest of both incoming contingents and employers;
2. The opening of this program is based on the consultation of the academic staff of the Department of Geography with colleagues from EU countries, in the framework of the ERASMUS + (GEOWEB) project. As such, it has national and European identity. Its main objective is the modernization of higher education;

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 88





3. The curriculum and syllabuses of the Master Professional Studies Program "Applied SIG" have been composed taking into consideration the experience of similar programs in the EU countries. This fact constitutes an obvious advantage for mutual cooperation, mobility as well as for indexing its level at the level of similar programs;
4. The laboratory base of this program is contemporary and will continue to remain so in the future due to cooperation with similar programs with EU partner countries;
5. The high rate of employment of graduates from this study program strengthens its image as a program worth attending;
6. The academic staff of this program has invested and invests its knowledge and dedication by creating an environment for students, where they feel not only welcomed but above all well treated in their efforts to become valuable professionals;

**b. Weak points:**

1. Failure to cover the teaching load of the study program to the extent of 70% by effective academic staff creates uncertainty in the planning of the annual workload and may lead to mandatory solutions by engaging academic staff with a contract, without the appropriate competence or by increasing the workload effective staff, outside the norms that define the standards: (Standards II-4, II-5);
2. Lack of access to the online library by students, limits them in the efficient use of literature; (Standard III-3);
3. The lack of an internal electronic communication system creates difficulties in identifying and solving problems in both the teaching and administrative processes; (Standard III-3);

**Recommendation**

1. The institution should recruit effective academic staff, to cover the workload of hours in the auditorium above 70%, in compliance with the by-laws in force;
2. To reduce the amount of supplementary hours for effective academic staff, at least up to 200 hours, which is the value determined by Instruction 29, dated 10.09.2018 of MASR;
3. To plan and organize more consultations with the labor market to receive and consider more of their feedback;
4. To add specific literature titles for this study program, mainly in foreign languages as they were missing from the current library funds and to enable access by students to the e-library;
5. To put the e-student system into operation as soon as possible for access to electronic documentation and dedicated personal space;
6. Being in the first steps, the Professional Master Studies Program "Applied SIG" needs constant institutional support to have stability in personnel and updating in infrastructure;



## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X